



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare

DEPARTAMENTI I PUNËS DHE PUNËSIMIT

PUNA *dhe* PUNËSIMI

Raporti Vjetor 2015

Parathënie

Qëllimi i raportit vjetor “Puna dhe Punësimi” është të ofrojë informacion për tregun e punës në Kosovë dhe të pasqyrojë të arriturat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në fushën e punësimit dhe aftësimit profesional. Ky raport pasqyron të gjitha zhvillimet dhe trendet të cilat ndodhin brenda vitit raportues për regjistrimin e të papunëve, punëkërkuësve dhe punëdhënësve dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave aktive të tregut të punës.



Të dhënat e përdorura në këtë raport, kryesisht janë nxjerrë nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), sistem i cili është në funksion të Zyrave të Punësimit dhe Qendrave për Aftësim Profesional. Nga ky aplikacion nxirren të gjitha të dhënat për papunësinë e regjistruar, vendet e lira të punës, ndërmjetësimet e rregullta në punësim, aftësimet profesionale dhe masat e tjera aktive të punësimit.

Pavarësisht se papunësia edhe më tutje mbetet sfidë e madhe, MPMS-ja gjatë kësaj periudhe ka arritur të regjistrojë 11.506 vende të lira të punës dhe krahasuar me të dhënat e vitit paraprak këto shifra tregojnë një ngritje prej 75.2%. Po ashtu, janë realizuar gjithsej 10.754 shërbime për të papunët me ç'rast 6.174 persona janë ndërmjetësuar në punësim të rregullt dhe përmes masave aktive të tregut të punës, që krahasuar me vitin paraprak paraqet ngritje për 32.3%. Njëkohësisht, 4055 punëkërkuës janë referuar në aftësime profesionale dhe 525 persona në trajnime tjera në kuadër të masave aktive të tregut të punës. Aftësimi profesional ka shënuar rritje nga viti paraprak për 18.6%.

Ky raport do të shërbejë për proceset e vendimmarrjes dhe për hartuesit e politikave brenda MPMS-së, por besoj që do të shërbejë edhe për institucionet e tjera relevante.

MPMS-ja është duke reformuar Shërbimet Publike të Punësimit me ç'rast shumë shpejt do të fillojmë me ofrimin e shërbimeve përmes platformës online për të gjithë punëkërkuësit dhe punëdhënësit. Gjithashtu, do të fillojmë të ndryshojmë mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj punëkërkuësit dhe të bëjmë më atraktive Zyrat e Punësimit dhe Qendrat tona për Aftësim Profesional me shpresën se do të arrihen rezultate shumë më të larta në vitin 2016.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale falenderon të gjithë donatorët të cilët kanë përkrahur realizimin e projekteve të përbashkëta profesionale dhe financiare si, UNDP, Banka Botërore, projektet EYE, GIZ, KE-EYWG, IOM, etj. Pa ndihmën e tyre dhe përkushtimin e stafit të MPMS-së nuk do të arriheshin këto rezultate.

Arban Abrashi,
Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Editor : Shpetim KALLUDRA, Menaxher
Sektori për Analiza ne Tregun e Punës dhe TI-se, DPP/MPMS
shpetim.kalludra@rks-gov.net

Jehona Namani-REXHA, Kryesuese
Divizioni i Aftësimit Profesional, DPP/MPMS
jehonanamani@hotmail.com

Ylber ALIU, Kryesues
Divizioni për Koordinimin e Zyrave te Punësimit, DPP/MPMS
ylber.aliu@rks-gov.net

Përgjegjës Defrim RIFAJ, Drejtor
Departamenti i Punës dhe Punësimit
dëfrim.rifaj@rks-gov.net

Adresa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Rr. UÇK-se Nr.1
10000 Prishtinë, Kosovë

Botuesi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Publikuar: Maj 2016
©: Departamenti i Punës dhe Punësimit /MPMS
Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Për përdorimin e të dhënave duhet theksuar burimi.

Përmbajtja	Faqe
HARTA E KOSOVËS	4
SHKURTIMET	5
LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE	7
Hyrje	8
Objektivat dhe Metodologjia	8
Përmbledhje ekzekutive	9
1 Papunësia e Regjistruar	11
1.1. Papunësia e regjistruar sipas viteve	11
1.2. Papunësia e regjistruar sipas kualifikimeve	11
1.3. Papunësia e regjistruar sipas profesioneve	12
1.4. Papunësia e regjistruar sipas grup-moshe	12
1.5. Papunësia e regjistruar sipas etnitetit	13
1.6. Papunësia e regjistruar sipas rajoneve	13
2 Shërbimet e Punësimit të ofruara nga SHPP-të	15
2.1. Vendet e lira të punës	16
2.1.1. Vendet e lira sipas Sektorit	16
2.1.2. Vendet e lira sipas profesionit	17
2.1.3. Vendet e lira sipas Kualifikimit	18
2.1.4. Vendet e lira sipas Rajonit	19
2.2. Punësimet e ndërmjetësuar	20
2.2.1. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas sektorëve ekonomik	21
2.2.2. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas profesioneve	22
2.2.3. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas kualifikimeve	23
2.2.4. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas moshës	24
2.2.5. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas etnitetit	25
2.2.6. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas gjinisë	25
2.2.7. Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas rajonit	26
3 Masat Aktive në Tregun e Punës	28
3.1. Aftësimet profesionale	28
3.1.1. Aftësimet profesionale sipas kualifikimeve	29
3.1.2. Aftësimet profesionale sipas moshës	30
3.1.3. Aftësimet profesionale sipas etnitetit	31
3.1.4. Aftësimet profesionale sipas gjinisë	32
3.1.5. Aftësimet profesionale sipas rajonit	32
3.2. Masat tjera aktive në tregun e punës	33
3.2.1. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas kualifikimeve	35
3.2.2. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas grup moshës	36
3.2.3. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas etnitetit	36
3.2.4. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas profesioneve	37
3.2.5. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas gjinisë	38
3.2.6. Masat tjera aktive në tregun e punës sipas rajonit	38
Aneks A Projektet e realizuara në kuadër të reformës	40
Aneks B Projektet e realizuara gjatë vitit 2015	41
Aneks C Vërtetimet për lajmërimin e punës për shtetas te huaj “30, 60, 90 dite	43
Aneks D Treguesit e Popullsisë dhe treguesit e Tregut të Punës	45
Aneks E Të dhëna dhe diagrame për punësimin	46
Aneks F Të dhënat e Aftësimit Profesional sipas profesioneve	47
Aneks G Kërkesa për fuqi punëtore: Vendet e lira dhe punësimet e rregullta në punësim	49
Definicionet dhe Terminologjia	

Harta e Kosovës

Departamenti i Punës dhe Punësimit

● Zyrat e Punësimit

■ Qendrat e Aftësisit Profesional në Kosovë



Shkurtesat

DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DMS	Departamenti i Mirëqenies Sociale
DP	Divizioni i Punësimit
ONP/ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës/Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO)
ONM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM)
FMN/IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ZKP	Zyra Komunale e Punësimit
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
QRP	Qendra Rajonale e Punësimit
ZSK	Zyra e Statistikave të Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
DAP	Divizioni për Aftësim Profesional
BB	Banka Botërore
AESH	Anketa e Ekonomive Shtëpiake
HZHNJ	Hulumtimi i Zhvillimit Njerëzor
SNKA/ISCED	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Arsimit
SNKP	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Profesioneve
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
SNKAE	Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin dhe Aktiviteteve Ekonomike

Lista e Tabelave

	Përmbajtja	Faqe
Tabela 1	Papunësia e regjistruar sipas viteve	11
Tabela 2	Papunësia e regjistruar sipas kualifikimeve	11
Tabela 3	Papunësia e regjistruar sipas profesioneve	12
Tabela 4	Papunësia e regjistruar sipas grup-moshe	12
Tabela 5	Papunësia e regjistruar sipas Etnitetit	13
Tabela 6	Papunësia sipas rajoneve	13
Tabela 7	Vendet e lira të punës sipas kualifikimeve	18
Tabela 8	Vendet e lira të punës sipas rajoneve	19
Tabela 9	Shkalla e Punësimit për 2015	20
Tabela 10	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas profesioneve	22
Tabela 11	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas kualifikimeve	23
Tabela 12	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas grup-moshave	24
Tabela 13	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas etnitetit	25
Tabela 14	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas gjinisë	25
Tabela 15	Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas rajoneve	26
Tabela 16	Masat Aktive në Tregun e Punës	28
Tabela 17	Aftësimet profesionale sipas kualifikimeve	29
Tabela 18	Aftësimet profesionale sipas grup-moshe	30
Tabela 19	Aftësimet profesionale sipas etniteteve	31
Tabela 20	Aftësimet profesionale sipas gjinisë	32
Tabela 21	Aftësimet profesionale sipas rajoneve	32
Tabela 22	MATP sipas kualifikimit	35
Tabela 23	MATP sipas grup-moshës	36
Tabela 24	MATP sipas etnitetit	36
Tabela 25	MATP sipas profesioneve	37
Tabela 26	MATP sipas gjinisë	38
Tabela 27	MATP sipas rajoneve	38

Lista e Figurave

	Përmbajtja	Faqe
Figura 1	Papunësia e regjistruar sipas stafit	14
Figura 2	Vendet e lira të punës për 12 Muaj	16
Figura 3	Vendet e lira të punës sipas sektorit ekonomik	16
Figura 4	Vendet e lira të punës sipas pronës	17
Figura 5	Vendet e lira të punës sipas profesioneve	17
Figura 6	SHRVLP sipas kualifikimeve për 12 muaj	18
Figura 7	SHRVLP sipas kualifikimeve për 12 muaj	19
Figura 8	SHVLS sipas rajoneve për 12 muaj	19
Figura 9	Punësimet e ndërmjetësuar për 12 Muaj	20
Figura 10	Punësimet e rregullta sipas sektorit ekonomik	21
Figura 11	Punësimet e rregullta sipas pronësisë për 12 muaj	22
Figura 12	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas profesioneve	23
Figura 13	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas kualifikimeve	24
Figura 14	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas moshe	24
Figura 15	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas etnitetit	25
Figura 16	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas gjinisë	26
Figura 17	Shkalla e ndërmjetësimeve të rregullta në punësim sipas rajoneve për 12 muaj	26
Figura 17a	SHPS sipas rajonit për 12 muaj	27
Figura 18	Pjesëmarrësit në Aftësim Profesional për 12 Muaj	29
Figura 19	SHT sipas kualifikimeve	30
Figura 20	SHT sipas grup-moshës	30
Figura 21	SHT sipas etniteteve	31
Figura 22	SHT sipas rajoneve	33
Figura 23	Shkalla e aktivizimit në masa aktive sipas kualifikimi	35
Figura 24	Shkalla e aktivizimit në masa aktive sipas moshës	36
Figura 25	Shkalla e aktivizimit në masa aktive sipas etnitetit	37
Figura 26	Shkalla e aktivizimit në masa aktive sipas profesioneve	37
Figura 27	Shkalla e aktivizimit në masa aktive sipas rajoneve	39

Hyrje

Raporti Vjetor “Puna dhe Punësimi” si raport i punës së DPP-së në vazhdimësi që prej vitit 2003, adreson çështje që ndërlidhen me punësimin dhe aftësimin profesional në Kosovë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar performancës së aktiviteteve që janë ndërmarrë nga Departamenti i Punës dhe Punësimit (DPP) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Bazuar në reformat e ndërmarra për SHPP-të kemi dy lloje të regjistrimeve të punëkërkuesve, si: (i) të papunët e regjistruar dhe (ii) punëkërkuesit e regjistruar.

Regjistrimi i të papunëve nënkupton ardhjen fizike për regjistrim në Zyrën e Punësimit. Po ashtu, të papunësuarit për ta vazhduar papunësinë duhet të paraqiten çdo 3 muaj në zyrën e punësimit. Nëse nuk paraqiten në Zyrat të Punësimit dy (2) herë radhas (3+3 muaj) atëherë këta persona janë jo aktiv dhe i ndërpritet mbajtja e evidencës.

Regjistrimi i Punëkërkuesve nënkupton të gjithë ata persona që janë të regjistruar nga jashtë (përmes interneti) në platformën online dhe të cilët nuk obligohen të vijnë fizikisht në zyrat e punësimit. Kjo kategori po ashtu mund të marrë shërbimet e nevojshëm nga SHPP-të pa ardhur fare në zyrat e punësimit përmes shërbimeve online të ofruara.

Objektivat dhe Metodologjia - Raporti Puna dhe Punësimi si raport i performancës pasqyron pjesën më të madhe të shërbimeve që ofrohen nga zyrat e punësimit dhe qendrat e aftësimit profesional. Paraqet të gjitha zhvillimet si, regjistrimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave aktive të punësimit. Fokusi kryesor është i drejtuar në monitorimin e performancës, ku përmes përcaktimit të indikatorëve të performancës në SIMP synohet në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të ofruara nga SHPP-ja. Prandaj shifrat e përdorura në këtë raport kryesisht u referohen të dhënave të mbledhura nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), nga zyrtarët e Zyrave të Punësimit (ZP) dhe nga Qendrat për Aftësim Profesional (QAP). Në bazë të kësaj, DPP-ja ka të zhvilluar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Punësimit, ku nga ky aplikacion nxjerrën të gjitha të dhënat, si: papunësinë e regjistruar, vendet e lira të punës, ndërmjetësimet në punësim dhe hyrjet në aftësimet profesionale. Po ashtu, këto të dhëna janë të ndara sipas gjinisë, kualifikimit, grup-moshës, etnitetit, rajonit, sektorit të aktivitetit, sektorit sipas pronësisë, etj. Sa u përket përcaktuesve të jashtëm të tregut të punës, siç është popullata, popullata me moshë punuese, popullata aktive dhe punësimi, raporti i referohet institucioneve tjera si burime sekondare.

Objektivat kryesorë të këtij raporti janë për mbështetjen e procesit të vendim marrjes dhe dizajnit të politikave brenda MPMS-së. Për më tepër ka për qëllim që të japë informata transparente në lidhje me zhvillimin e punës dhe punësimit për të gjitha institucionet relevante dhe për publikun e gjerë sipas interesimit, duke:

- Paraqitur dhe analizuar strukturat dhe faktet e papunësisë së regjistruar, aspekteve socio-demografike, gjinisë, kualifikimeve, moshës dhe etnitetit;
- Analizimi i vendeve të lira të punës të ofruara nga tregu i punës dhe i regjistruar në Zyrat e Punësimit dhe punësimet e ndërmjetësuar, përmes SHPP-se.
- Hyrjet në aftësimet profesionale të papunëve dhe rezultati i aftësimit profesional si masë për të avancuar mundësinë e punësimit për të regjistruarit si të papunë;
- Pasqyre e zhvillimit të masave aktive në tregun e punës.

Përmbledhje

- Numri i përgjithshëm i te papunëve te regjistruar nga shërbimet publike te punësimit deri ne fund te vitit 2015 është 112.179 persona, ku prej tyre femra janë 48.960 ndërsa mashkuj 63.219 persona.
- Numri i përgjithshëm i te papunëve te regjistruar si te “Pa kualifikuar” është 68.395 persona ose 61.0%, ndërsa te papunët e regjistruar me “sh.mesme” arrijnë shifrën prej 21.006 persona ose 18.7% si dhe me “universitet” me 5.052 ose 4.5%.
- Papunësia e regjistruar sipas grup moshave me se shumti i referohet moshës prej 25-39 vjeçar me 48.1%, pastaj grup moshë 40-54 merr pjese me 33.6% ne papunësi te regjistruar. Grup moshë e te rinjve 15-24 dhe me te vjetërve 55-64 marrin pjese respektivisht me 9.5% dhe 8.8% e regjistrimeve.
- Numri me i lartë i te papunëve është regjistruar ne Prishtinë me 24.966 persona ose ne mënyrë proporcionale me 22%, pastaj Prizreni me 18% ose 19.867 persona si dhe Mitrovica me 15% ose 12.800 persona. Numri me i madhe i te papunëve për staf është realizuar ne rajonin e Prizrenit me 2207:1, pastaj Ferizajt me 1372:1. Ndërsa me papunësinë me te ulte për staf është përballur rajoni i Pejës me 895:1 si dhe Gjakovës me 1033:1.
- Gjithsejtë 11.506 vende te lira te punës janë regjistruar gjate vitit 2015 ne shërbimet publike te punësimit (SHPP). Nëse krahasojmë të dhënat më 2014-ën kemi ngritje prej më shumë se 75.2%.
- Gjatë vitit 2015, sikur në vitet e mëparshme, shumica e vendeve të lira të ofruara i referohen sektorit terciar (shërbimet, 68%), pasuar nga sektori sekondar (prodhimi 29%) dhe sektori primar (bujqësia 3%).
- Vendet e lira të punës për periudhën raportuese kryesisht janë në profesionet elementare më 28.9%, pastaj zejtarët dhe punëtorët e ngjashëm me 19.5% dhe punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes dyqane dhe treg me 19.3%.
- Vendet e lira të punës të regjistruara më së shumti i referohen rajonit të Prishtinës me 2449 vende ose me 21.3%, ndjekur nga Prizreni me 1949 vende të lira ose me 16.9% pastaj rajoni i Pejës me 1622 vende të lira ose 14.1%. Vende të lira të punës të regjistruara më së paku i referohen rajonit të Ferizajt me 1018 vende ose me 8.8%.
- Gjatë këtij viti raportues Zyrat e Punësimit kanë realizuar 6.174 ndërmjetësime në punësim të rregullta dhe përmes masave aktive të tregut të punës për personat e regjistruar si të papunë. Kështu që, nëse shikojmë vitin paraprak kemi një ngritje për këtë vit raportues 2015 tek ndërmjetësimet në punësim për 32.3%. *Shkalla e Punësimit për vitin 2015 është 5.5%.*
- Në mënyrë proporcionale “Profesionet elementare” arrijnë numrin më të madh të ndërmjetësimeve në punësim prej 29.6%, ndjekur nga “punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqane” me 16.5%, pastaj “technikët dhe profesionet e ngjashme” me 16.2%.

- Ndërmjetësimet në punësim janë realizuar më së shumti me shkollë të mesme deri 35.5%, ndjekur nga grupi me shkollë fillore prej 27.4% pastaj të pakualifikuarit me 25.2%.
- Sa i përket zhvillimit brenda rajoneve të Kosovës, zyra e punësimit në Prishtinë në vitin 2015 kanë realizuar numrin më të lartë të punësimeve në shifra absolute për periudhën raportuese 12 mujore e cila arrin në 860 persona apo 24.1%, pasuar nga Gjakova dhe Peja me 17.8% (636) respektivisht me 16.1% (575).
- Gjithsej 4055 të papunë kanë hyrë në trajnime gjatë vitit 2015, të shpërndarë në më shumë se 30 profesione të Qendrave të Aftësimit Profesional. Nëse krahasohet me vitin 2014 numri i pjesëmarrësve në Aftësim Profesional është rritur prej 18.6%.
- Sa u përket niveleve të ndryshme të kualifikimeve në Aftësimet Profesionale, shifrat e raportuara gjatë vitit 2015, tri grupet e kualifikimit më të lartë ende realizojnë në mënyrë proporcionale përqindje shumë më lartë sesa tri grupet me kualifikim më të ulët.
- Qendrat e Aftësimi Profesional edhe gjatë vitit 2015 i kanë dhënë rëndësi grup-moshës së të rinjve, që në mënyrë proporcionale grup-mosha 15-24 merr pjesë me 44.6%, pasuar nga grup-mosha tjetër 25-39 me 42.5%. Kurse grup-mosha 40-54 dhe 55+ marrin pjesë me 12.1%, respektivisht me 0.8%.
- Shkalla e Trajnimit në mesataren kosovare e cila gjatë këtij viti raportues është 3.6% nxjerr në pah një ndikim të vogël mbi-proporcional të shqiptarëve me 3.8%. Mirëpo komunitetet e tjera në mënyrë nënproporcionale janë nën mesataren kosovare, ku serbët marrin pjesë me 2.1%, ndërsa minoritetet e tjera me 2.4%. Kështu që të gjitha minoritetet marrin pjesë me 2.3% e cila përsëri është nën vlerat e mesatares kosovare.
- Aftësimet Profesionale (AP) sipas rajoneve, pasqyron rezultate të ndryshme, ku rajoni i Prizrenit në mënyrë proporcionale dominon me 28% ose 1134 pjesëmarrës kundrejt rajoneve tjera. Pas këtij rajoni renditet Rajoni i Pejës me 18.6% ose 754 pjesëmarrës në trajnime.
- Gjithsej 3.125 të papunë janë aktivizuar gjatë vitit 2015 në të tjera masa aktive të punësimit. Të gjitha këto masa janë realizuar brenda periudhës raportuese. Shkalla e Aktivizimit në masa aktive të tregut të punës ka qenë 2.8%.
- Shkalla e Aktivizimit për masat e tjera aktive të punësimit sipas grup-moshës 15-24 arrijnë në 11.1%. Ndërsa grup-moshat e tjera si 25-39, pastaj 40-54 dhe 55+ marrin pjesë me shkallë më të ultë të aktivizimit, bile nën vlerat mesatare e cila në shkallë vendi është 2.8%.
- Shkalla e Aktivizimit për masat e tjera aktive të punësimit në mesataren kosovare e cila gjatë këtij viti raportues është 2.8% nxjerr në sipërfaqe në mënyrë mbi-proporcional minoritete tjera me 6.7%. Po ashtu, komuniteti serb merr pjesë me 3.5% të shkallës së aktivizimit e cila është dukshëm mbi mesataren kosovare prej 2.8%. Shkalla e Aktivizimit në masa aktive për shqiptarët është nën vlerat mesatare prej 2.4%.

1. PAPUNËSIA E REGJISTRUAR

1.1. Papunësia e regjistruar sipas viteve

Numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar nga shërbimet publike të punësimit deri në fund të vitit 2015 është 112.179 persona, ku prej tyre femra janë 48.960 ndërsa meshkuj 63.219 persona.

Tab.1: Papunësia e regjistruar sipas viteve

Përshkrimi	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Papunësia e regjistruar “2013”	74,475	32,327	42,148
Hyrje 12 mujore	8,848	4,243	4,605
Papunësia e regjistruar “2014”	83,323	36,570	46,753
Rritja 12 mujore (%)	11.9	13.1	10.9
Papunësia e regjistruar “2015”	112,179	48,960	63,219
Rritja 12 mujore (%)	34.6	33.9	35.2

Hyrjet në papunësi për 12 muaj tregojnë rritje afërsisht prej 34.6% duke krahasuar me numrin e të regjistruarave nga viti paraprak (2014) i cili ishte vetëm 11.9%, po ashtu sikurse femrat edhe meshkujt janë rritur në regjistrime prej 33.9% përkatësisht 35.2%.

Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së performancës së këshilltarëve të punësimit të cilët kanë pasur si qëllim ofrimin e shërbimeve edhe për persona të cilët deri tani nuk kanë qenë të regjistruar në zyrat e punësimit.

1.2. Papunësia e regjistruar sipas kualifikimeve

Numri i përgjithshëm i të papunëve të regjistruar si të “Pakualifikuar” është 68.395 persona ose 61.0%, ndërsa të papunët e regjistruar me “sh. mesme” arrijnë shifrën prej 21.006 persona ose 18.7% si dhe me “universitet” me 5.052 ose 4.5%. Ndërsa numri i të regjistruarave me master mbetet në shifra modeste prej 226 persona ose 0.2%.

Tab. 2: Papunësia e regjistruar sipas kualifikimeve

Arsimimi	Totali	(%)	Femra	Meshkuj
Pa Kualifikuar	68395	61.0%	31893	36502
Shkolle Fillore	17500	15.6%	7563	9937
Shkolle e Mesme	21006	18.7%	6630	14376
Universitet	5052	4.5%	2775	2277
Master	226	0.2%	99	127
Dr. shkencave	-	-	-	-
Total	112,179	100%	48,960	63,219

1.3. Papunësia e regjistruar sipas profesioneve

Papunësia e regjistruar sipas profesioneve për këtë vit raportues më së shumti i referohet të papunësuarve të regjistruar në profesionet elementare me 72.2% prej shumicës absolute, pastaj janë teknikët dhe profesionistët e ngjashme me 7.2% si dhe profesionistët me 5.6%.

Tabela 3: Papunësia e regjistruar sipas profesioneve

Profesionet	Total	%	Femra	Meshkuj
Ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët	598	0.5%	307	291
Profesionistët	6335	5.6%	3240	3095
Teknikët dhe profesionistët e ngjashëm	8064	7.2%	2832	5232
Nëpunësit	2397	2.1%	1119	1278
Punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqan dhe treg	4767	4.2%	2416	2351
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	1107	1.0%	732	375
Zejtari dhe punëtorët e ngjashëm	6983	6.2%	1161	5822
Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave	932	0.8%	94	838
Profesionet elementare	80996	72.2%	37059	43937
Forcat e armatosura	-	-	-	-
Total	112,179	100.0%	48,960	63,219

Kurse numrin më të vogël të të papunëve të regjistruar e përbëjnë ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët me 0.5% si dhe operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinerive 0.8%.

1.4. Papunësia e regjistruar sipas grup-moshës

Papunësia e regjistruar sipas grup-moshave më së shumti i referohet moshës prej 25-39 vjeçar me 48.1%, pastaj grup-mosha 40-54 merr pjesë me 33.6% në papunësi të regjistruar. Grup-mosha e të rinjve 15-24 dhe më të vjetërve 55-64, marrin pjesë me 9.5% e regjistrimeve respektivisht 8.8%.

Tabela 4: Papunësia e regjistruar sipas grup-moshave

Grup-mosha	Totali	(%)	Femra	Meshkuj
15 - 24	10603	9.5%	4914	5689
25 - 39	53983	48.1%	24136	29847
40 - 54	37685	33.6%	15888	21797
55+	9908	8.8%	4022	5886
Total	112,179	100%	48,960	63,219

Regjistrimi i papunësisë për të rinjtë me vetëm 9.5%, sigurisht tregon që një numër i madh prej tyre, vazhdojnë arsimin universitar duke mos qenë pjesë aktive e tregut të punës.

1.5. Papunësia e regjistruar sipas etniteteve

Shërbimit Publike të Punësimit edhe gjatë këtij viti raportues pasqyrojnë shifra mjaft të larta në regjistrimet e papunësisë. Shqiptarët marrin pjesë me 99.153 persona ose 88.4%, kurse sa i përket regjistrimeve të papunësisë për minoritetin serb ka qenë 4.319 persona ose 3.9%.

Tabela 5: Papunësia e regjistruar sipas etnitetit

Etniteti	Totali	(%)	Femra	Meshkuj
Shqiptar	99153	88.4%	43027	55754
Serb	4319	3.9%	1898	2421
Minoritete tjera	8707	7.8%	4035	5044
Gjithë Minoritetet	13026	11.6%	5933	7465
Total	112,179	100.0%	48,960	63,219

Ndërsa minoritetet e tjera jo shumicë kanë marrë pjesë në regjistrimin e papunësisë prej 8.707 persona ose 7.7%. Të gjitha minoritetet marrin pjesë me 13.026 persona ose me 11.6% të të gjitha regjistrimeve në papunësi.

1.6. Papunësia e regjistruar sipas rajoneve

Numri më i lartë i të papunëve është regjistruar në Prishtinë me 24.966 persona ose në mënyrë proporcionale me 22%, pastaj Prizreni me 18% ose 19.867 persona si dhe Mitrovica me 15% ose 12.800 persona.


Tabela 6: Papunësia e regjistruar sipas rajoneve

Rajoni	Papunësia	%	Femra	Meshkuj	Sh. papunësisë ¹ sipas stafit
Ferizaj	13,723	12%	6,066	7,657	1372:1
Gjakovë	12,394	11%	5,664	6,730	1033:1
Gjilan	14,050	13%	6,337	7,713	1081:1
Mitrovicë	16,441	15%	6,678	9,763	1174:1
Pejë	10,738	10%	4,833	5,905	895:1
Prishtinë	24,966	22%	10,299	14,667	1135:1
Prizren	19,867	18%	9,083	10,784	2207:1
Total	112,179	100%	48,960	63,219	1219:1

Rajoni i Pejës përballlet me numrin më të vogël të regjistrimeve me vetëm 10% ose 10.738 persona, ndërsa rajoni i Gjakovës ka të regjistruar 12.394 persona ose 11%.

¹ Shkalla e papunësisë në raport me stafin i referohet numrit të papunësuarve në raport me keshilltarët e punësimit.

Shërbimit Publike të Punësimit prej 92 këshilltarëve për punësim është dashur të ofrojnë shërbime për 112.179 persona të regjistruar si të papunë.




Numri më i madh i të papunëve për staf është realizuar në rajonin e Prizrenit me 2207:1, pastaj Ferizajt me 1372:1. Ndërsa me papunësinë më të ultë për staf është përballur rajoni i Pejës me 895:1 si dhe Gjakovës me 1033:1 (shih. fig. 1).

2. SHËRBIMET E PUNËSIMITË OFRUARA NGA SHPP-të

Modeli i ofrimit të shërbimeve të punësimit - Duke marrë në shqyrtim procedurat e Shërbimit Publik për Punësim (SHPP) në përgjithësi, detyra e tyre kryesore është e fokusuar në regjistrimin e të papunëve me qëllim të riintegrit të tyre në punësim dhe aftësim profesional.

Të papunësuarit: - Pas regjistrimit në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Punësimit, hapi tjetër nënkupton të këshillohen me qëllim të punësimit në të ardhmen dhe/apo orientimit në karrierë. Nëse është e nevojshme të përshtatet një orientim për tregun e punës, do të vihet në mes një aftësim/trajnim profesional ndërmjet, në mënyrë që të fitohen kualifikimet e kërkuara.


Punëdhënësit: - Objektivi për t'i punësuar të papunët është i bazuar në krijimin e suksesshëm të vendeve të lira të punës, si dhe përshtatjen në mënyrë të duhur të të papunëve, siç ofron



personeli me kërkesën e raportuar. Kjo procedurë zakonisht quhet *Ndërmjetësim i Punësimit*. Punëdhënësit e kontaktuar krijojnë vendet e lira të punës (kërkesa për fuqi punëtore) dhe sjellin të papunët (furnitorët e fuqisë punëtore). Në detaje, do të ilustruhet në kapitullin në vijim.

2.1. Vendet e lira të punës

Gjatë vitit 2015 janë regjistruar në Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP), gjithsej 11.506 vende të lira të punës. Nëse krahasojmë të dhënat me 2014-ën kemi ngritje prej më shumë se 75.2%.




Duke iu referuar numrit të personave që janë regjistruar si të papunë, numri i vendeve të lira të krijuara rezulton në Shkallë Regjistrimi të Vendeve të Lira (SHRVL) prej 10.2% në vitin 2015.

Brenda një periudhe 12 mujore, ka qenë 1 vend i lirë i punës në dispozicion për rreth 10 të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit. Duke pasur parasysh mesataren mujore atëherë do të kemi një përshtypje më realiste për situatën. Sipas statistikave çdo muaj më shumë se 116 të papunë është dashur të konkurrojnë për 1 vend të lirë pune të ofruar.

2.1.1. Vendet e lira të punës sipas sektorit

Gjatë vitit 2015, sikur në vitet e mëparshme, shumica e vendeve të lira të ofruara i referohen sektorit terciar (shërbimet, 68%), pasuar nga sektori sekondar (prodhimi, 29%) dhe sektori primar (bujqësia, 3%).


Sektori terciar tregon një ngritje modeste në numrin e vendeve të lira të punës gjatë kësaj



periudhe raportuese prej 63%, sa ishte në vitin 2014 në 68% në vitin 2015. Po ashtu edhe sektori sekondar tregon vlera modeste të rritjes prej 22% sa ishte në vitin 2014 në 29%.

Kurse sektori primar tregon një rënie prej 15% sa ishte në vitin e kaluar në 3% për vitin 2015.

Sa u përket zhvillimeve në tregun e punës në Kosovë të ndara sipas sektorit të pronësisë, numri i përgjithshëm i vendeve të lira të punës, iu është referuar sektorit privat. Sipas rezultateve të përgjithshme në vitin 2015 sektori privat ka realizuar ngritje të lehtë prej 64% sa ishte në vitin paraprak në 67% për vitin 2015.




Ndërsa sektori publik ka shënuar rënie prej 36% sa ishte në vitin 2014, në 33% për vitin 2015 (shih fig.4). Mirëpo me rëndësi është se në mënyrë proporcionale vendet e lira të punës në sektorin privat janë 67% krahasuar me sektorin publik prej 33%.

2.1.2. Vendet e lira të punës sipas profesioneve

Vendet e lira të punës për periudhën raportuese kryesisht janë në profesionet elementare me 28.9%, pastaj zejtarët dhe punëtorët e ngjashëm me 19.5% dhe punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes dyqane dhe treg me 19.3%.

Ndërsa vendet e lira të punës janë më të vogla për ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët



janë me 1.7%, kurse Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave si dhe punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari arrin në 2.9% të të gjitha vendeve të lira të punës për vitin 2015. (shih fig. 5)

2.1.3. Vendet e Lira sipas kualifikimeve


Tab.6: Vendet e lira të punës sipas kualifikimeve

Kualifikimi	Vendet e lira të punës	%	ShRVLP ²
Pa Kualifikuar	390	3.4%	1%
Shkolle fillore	4192	36.4%	24%
Shkolle e mesme	5232	45.5%	25%
Universitet	1671	14.5%	33%
Master	21	0.2%	9%
Dr. shkencave	-	-	-
Total	11506	100%	10%

Kërkesat që vijnë nga tregu i punës kryesisht iu referohen vendeve të lira të punës me shkollë të mesme me 5232 ose 45.5%, pastaj me shkollë fillore me 4192 ose 36.4% si dhe universitet me 1671 vende të lira ose 14.5%.

Kurse kërkesat e tregut të punës me numër më të vogël të vendeve të lira të punës janë tek kualifikimi master me 21 ose 0.2% dhe të pakualifikuarit me 390 ose 3.4%.

Në disproporcion me vitet tjera, në vitin 2015 shkalla e vendeve të lira të regjistruara është me



universitet me 33%, ndjekur nga kualifikimet me shkollë të mesme me 25% dhe shkollë fillore me 24%. Ndërsa shkalla e vendeve të lira të regjistruara me përqindjen më të vogël i referohet të pakualifikuarve me 1% dhe master me 9%.

² ShRVLP- Shkalla e Regjistrimit e Vendeve të Lira të Punës - është numri i vendeve të lira të punës në përpjestim me regjistrimin e papunësisë.

2.1.4. Vendet e Lira sipas rajoneve

Vendet e lira të punës të regjistruara më së shumti i referohen rajonit të Prishtinës me 2449 vende ose me 21.3%, ndjekur nga Prizreni me 1949 vende të lira ose me 16.9%, pastaj rajoni i Pejës me 1622 vende të lira ose 14.1%. Vende të lira të punës të regjistruara më së paku i referohen rajonit të Ferizajt me 1018 vende ose me 8.8%.

Tabela.7: Vendet e lira të punës sipas rajoneve

Rajonet	Vendet e lira	%	Ndryshimi me 2014	ShVLS ³	ShRVLP
Ferizaj	1018	8.8%	58%	102:1	7%
Gjakovë	1475	12.8%	91%	123:1	12%
Gjilan	1343	11.7%	37%	103:1	10%
Mitrovicë	1650	14.3%	76%	118:1	10%
Pejë	1622	14.1%	25%	135:1	15%
Prishtinë	2449	21.3%	128%	111:1	10%
Prizren	1949	16.9%	127%	217:1	10%

Në krahasim me rajonet e tjera, shkalla më e lartë e regjistrimit të vendeve të lira (SHRVLP) në vitin 2015 ishte raportuar nga zyrat e rajonit të Pejës (15%), Gjakovës (12%).

Derisa rajoni i Ferizajt (7%), në vitin 2015 është përballur me rënien më të ulët sa u përket vendeve të lira të ofruara.

Me fjalë të tjera derisa në rajonin e Gjilanit në mesataren mujore sipas statistikave rreth 162 të papunë është dashur të konkurrojnë për 1 vend të lirë të ofruar, ky relacion ishte rreth 79 me 1 në rajonin e Pejës.

Numri më i lartë i vendeve të lira në raport me stafin përkatës (SHVLS) në vitin

2015 ishte arritur nga zyrtarët e punësimit në rajonin e Prizrenit me 217:1 (shih fig.7).

Fig.7: ShRVLP sipas kualifikimeve per 12 muaj





Fig.8: ShVLS sipas rajoneve per 12 muaj



³ ShVLS- Shkalla e Vendeve të Lira të Punës- është numri i vendeve të lira të punës në përpjesëtim me stafin (Këshilltarët e Punësimit).

2.2. PUNËSIMET E NDËRMJETËSUARA


Shërbimet e punësimit gjatë kësaj periudhe raportuese do të ndahen në: (i) ndërmjetësime të rregullta në punësim⁴ dhe (ii) ndërmjetësime në punësim nga masat aktive të tregut të punës⁵.

Prandaj, të dhënat që do pasqyrohen në këtë pjesë do të jenë vetëm për ndërmjetësime të rregullta në punësim, të cilat realizohen nga Zyrat e Punësimit, ndërsa të dhënat e tjera me ndërmjetësime në punësim nga masat aktive të tregut të punës, do pasqyrohen në pjesën tjetër të këtij raporti.

Tabela 8: Shkalla e Punësimit për 2015

	Gjithsejte
Papunësia	112.179
Vendet e lira të punës	11.506
Punësimet	6.174
- Ndërmjetësime të rregullta	(3.574)
- Ndërmjetësime në punësim nga MATP	(2.600)
SHPVLP	54%
Shkalla Punësimit⁶	5.5%

Indikatori më i rëndësishëm sa i përket të gjitha aktiviteteve të realizuara në tregun e punës është promovimi i punësimit.



Një ndër objektivat kryesore të Shërbimeve Publike të Punësimit në Kosovë është ndërmjetësimi në punësim, pra, integrimi në tregun e punës dhe punësimi i të papunëve.

⁴ Punësimi i rregullt bëhet në mënyrë direkte përmes Punëdhënësve, ku ata paraqesin kërkesat e tyre tek zyrat e punësimit dhe pas kësaj bëhet përputhja e ofertës (të papunëve të regjistruar).

⁵ Punësimi përmes masave aktive në tregun e punës bëhet duke subvencionuar vendin e punës në mënyrë direkte apo indirekte përmes Punëdhënësve.

⁶ Shkallë e punësimit është numri i të ndërmjetësuarve në punësim gjatë vitit, në raport me papunësinë e regjistruar.

Gjatë këtij viti raportues Zyrat e Punësimit kanë realizuar 6.174 ndërmjetësime në punësim të rregullta dhe përmes masave aktive të tregut të punës për personat e regjistruar si të papunë.


Shkalla e Punësimit për vitin 2015 është 5.5%.

Shkalla e punësimit në raport me vendet e lira arrin shifrën prej 54%, duke iu referuar numrit të punësimeve të realizuara me rezultatet e numrit të vendeve të lira të raportuara.

2.2.1. Ndërmjetësimet e rregullta të punësimit sipas sektorëve ekonomik


Kërkesat që vijnë nga tregu i punës përmes hulumtimit që behën nga këshilltarët e punësimit pasqyrojnë zhvillimet që ndërlidhen me ndërmjetësimet në punësim sipas sektorëve ekonomik.

Në vazhdimësi sektori terciar mbetet sektori i cili më së shumti gjeneron vende pune dhe po ashtu gjatë kësaj periudhe raportuese ky sektor arrin të absorbojë deri në 68.0% të të gjitha ndërmjetësimeve në punësim.



Nëse krahasohet me vitin paraprak kemi një rritje prej 56.9% në 68.0% në vitin 2015. Sektori sekondar (prodhimi) ka ngritje të lehtë nga viti paraprak prej 20.2% në 28.8% gjatë vitit 2015. Sektori primar gjatë këtij viti raportues tregon vlera në rënie prej 22.9% sa ishte në vitin 2014 në 3.1% për vitin 2015 (shih fig.10).

Në vazhdimësi punësimet rregullta të ndërmjetësuar sipas pronësisë përsëri pasqyrojnë vlera krahasuese ndërmjet dy sektorëve. Gjatë vitit raportues pjesa e të gjitha ndërmjetësimeve në punësim që i referohet sektorit publik ka rënie prej 38% sa ishte në vitin paraprak në 24% gjatë këtij viti raportues.



Ndërsa, ekonomia e sektorit privat në të njëjtën kohë ka absorbuar gati 76% të të gjitha punësimeve të realizuara, dhe nëse krahasohet me vitin 2014, ngritja është po ashtu mjaft e theksuar prej 62% sa ishte në vitin paraprak në 76% për vitin 2015. (shiko fig. 11).

2.2.2. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas profesioneve


Punësimet e realizuara përmes profesionit paraqet një vlerë të re raportuese duke pasur parasysh përputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Tabela 9: Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas profesioneve

Profesionet	Total	%	Regjistrimi	ShP
Ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët	42	1.2%	598	7.0%
Profesionistët	373	10.4%	6335	5.9%
Teknikët dhe profesionistët e ngjashme	578	16.2%	8064	7.2%
Nëpunësit	245	6.9%	2397	10.2%
Punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqan dhe treg	589	16.5%	4767	12.4%
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	56	1.6%	1107	5.1%
Zejtaret dhe punëtorët e ngjashëm	568	15.9%	6983	8.1%
Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave	65	1.8%	932	7.0%
Profesionet elementare	1,058	29.6%	80996	1.3%
Forcat e armatosura	-	-	-	-
Total	3,574	100%	112179	3.2%

Në mënyrë proporcionale “Profesionet elementare” arrijnë numrin më të madh të ndërmjetësimeve në punësim prej 29.6%, ndjekur nga “punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqane” me 16.5%, pastaj “tekniket dhe profesionet e ngjashme” me 16.2%.

Ndërmjetësimet në punësim të bëra tek profesionet “Ligjvënësit, zyrtarët dhe menaxherët e lartë” arrijnë të absorbojnë numrin më të vogël prej 1.2%, pastaj “punëtorët e kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari” me 1.6%.



Mirëpo, shkalla e punësimit i referohet të papunëve të regjistruar me profesionin si punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes me 12.4% e cila është dukshëm mbi mesataren kosovare prej 3.2%, ndjekur nga nëpunësit me 10.2% si dhe zehtarët dhe punëtorët e ngjashëm me 8.1%. Ndërsa nën vlerat mesatare shkalla më e lartë e ndërmjetësimeve në punësim është arritur për profesionet elementare me 1.3%.

2.2.3. Ndërmjetësimet të rregullta në punësim sipas kualifikimeve

Ndërmjetësimet në punësim janë realizuar më së shumti me shkollë të mesme deri 35.5%, ndjekur nga grupi me shkollë fillore prej 27.4%, pastaj të pakualifikuarit me 25.2%.

Kualifikimet e tjera kanë treguar përqindje më të ultë të ndërmjetësimit në punësim dhe atë, në vlera tejet të vogla, si me master janë realizuar vetëm 0.6%.

Tabela 9: Ndërmjetësimet të rregullta në punësim sipas kualifikimeve

Kualifikimi	Total	%	Papunësia	ShP
Pa Kualifikuar	901	25.2%	68395	1.3%
Shkollë fillore	978	27.4%	17500	5.6%
Shkolle e mesme	1,270	35.5%	21006	6.0%
Universitet	405	11.3%	5052	8.0%
Master	20	0.6%	226	8.8%
Dr. shkencave	-	-	-	-
Total	3,574	100%	112,179	3.2%

Shkalla e Punësimit mbi mesataren kosovare, duke iu referuar punësimeve të realizuara, atëherë vihet në dukje se veçanërisht rezultatet e larta janë arritur për nivelin e kualifikimeve “master” me 8.8%, universitet me 8.0% dhe “shkolle e mesme” me 6.0%. Ndërsa nën mesataren kosovare prej kanë pësuar të “pakualifikuarit” me 1.3%.



2.2.4. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas grup-moshave


Numri më i madh i të punësuarave në mënyrë proporcionale shkon për grup moshën 25-39 me 47.3%, pastaj për grup moshën 15-24 me 23.2%, ndjekur nga dy grup moshat tjera 40-54 me 25.45 dhe 55+ me 4.1%.

Tab. 10: Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas grup-moshave

Grup-mosha	Punësim	%	Papunësia	ShP
15 - 24	829	23.2%	10.603	7.8%
25 - 39	1692	47.3%	53.983	3.1%
40 - 54	907	25.4%	37.685	2.4%
55+	146	4.1%	9.908	1.5%
Total	3574	100%	112.179	3.2%

Pasqyra e përgjithshme në rezultate në vitin 2015, Shkalla e Punësimit (SHP) është arritur për grupin e të rinjve (15-24) me 7.8%, pasuar nga grup-mosha (25-39) me 3.1%, ndërsa dy grup-moshat tjera (40-54 dhe 55+) kanë treguar rezultate më të ulëta me 2.4% respektivisht me 1.5% (shih. fig.14).

Grup-moshat e reja kane gjasa më të mëdha në punësim krahasuar me grupet më të vjetra për nga mosha.



2.2.5. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas etnitetit

Nga gjithsej 3574 ndërmjetësimet e rregullta në mënyrë proporcionale shqiptarët marrin pjesë me 95%. Krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 86% në 95% gjatë kësaj periudhe raportuese.


Tab. 11: Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas etnitetit

Kualifikimi	Punësim	%	Papunësia	ShP
Shqiptar	3397	95.0%	98781	3.4%
Serb	28	0.8%	4319	0.6%
Minoritete tjera	149	4.2%	2418	6.2%
Gjithë Minoritetet	177	5.0%	6661	2.7%
Total	3574	100%	112,179	3.2%

Ndërsa të gjitha minoritetet marrin pjesë me 5.0 % që krahasuar me vitin paraprak kemi rënie në ndërmjetësimet në punësim. Mirëpo në mënyrë të veçantë, në përjashtim të komuniteteve tjera pakicë, serbët marrin pjesë me 0.8% ose 28 ndërmjetësime në punësim.

Minoritetet e tjera (jo serbe) gjatë kësaj periudhe raportojnë mbi mesataren kosovare me 6.2% të shkallës së punësimit (shih. tab. 11 dhe fig. 14).

Sa i përket relacionit të punësimeve dhe papunësisë së regjistruar, shqiptarët e Kosovës realizojnë shkallën e punësimit për 12 muaj (SHP) prej se 3.4%, gjë e cila është pakëz më e lartë se mesatarja në shkallë vendi që është 3.2%.



2.2.6. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas gjinisë


Shërbimet Publike të Punësimit kanë realizuar 33.7% e ndërmjetësimeve të rregullta për gjininë femërore ose 1.205 persona, ndërsa meshkuj janë ndërmjetësuar me 66.3% ose me 2.369 persona.

Tabela 19: Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas gjinisë

	Femra	Meshkuj	Total
Papunësia	48.960	63.219	112.179
Punësimet	1,205	2.369	3.574
ShP	2.5%	3.7%	3.2%
Proporcioni	33.7%	66.3%	100%

Shkalla e Punësimit tek femrat e papuna është 2.5%, ndërsa meshkujt arrijnë rezultate prej 3.7% për vitin 2015.

Realisht femrat janë nën vlerat e mesatares kosovare e cila është 3.2%, kurse meshkujt në mënyrë mbi proporcionale tejkalojnë këto vlera prej 3.7%.



2.2.7. Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas rajoneve


Sa i përket zhvillimit brenda rajoneve të Kosovës, Zyra e Punësimit në Prishtinë në vitin 2015 kanë realizuar numrin më të lartë të punësimeve në shifra absolute për periudhën raportuese 12 mujore e cila arrin në 860 persona apo 24.1%, pasuar nga Gjakova dhe Peja me 17.8% (636) respektivisht me 16.1% (575).

Tabela 12: Ndërmjetësime të rregullta në punësim sipas rajoneve

Rajonet	Punësimi i rregullt	%	Papunësia e regjistruar	ShP	ShPS ⁷
Ferizaj	201	5.6%	13,723	1.5%	20:1
Gjakovë	636	17.8%	12,394	5.1%	53:1
Gjilan	437	12.2%	14,050	3.1%	34:1
Mitrovicë	345	9.7%	16,441	2.1%	25:1
Pejë	575	16.1%	10,738	5.4%	48:1
Prishtinë	860	24.1%	24,966	3.4%	39:1
Prizren	520	14.5%	19,867	2.6%	58:1
Total	3,574	100%	112,179	3.2%	39:1

Numri më i ulët i punësimeve ishte raportuar nga rajoni i Ferizajt me ndërmjetësime në punësim me vetëm 5.6% ose 201 persona të ndërmjetësuar (shih. tab. 12)


Bazuar në Shkallën e Punësimit në Kosovë e cila është 3.2%, brenda rajoneve në Kosovë shkalla më e lartë e punësimeve është regjistruar në rajonin e Pejës me



⁷ Shkalla e Punësimit me Staf – është numri i ndërmjetësimeve të rregullta në punësim në raport me stafin (Këshilltarët e Punësimit)

5.4%, pasuar nga rajoni i Gjakovës me 5.1%, Prishtinës me 3.4%.

Ndërsa Rajoni i Ferizajt përballët me shkallën më të ultë prej 1.5% e cila është dukshëm nën mesataren kosovare njëjtë sikurse rajoni i Mitrovicës dhe Prizrenit me 2.1% respektivisht 2.6%.



Zyrtarët e punësimit në rajonin e Ferizajt realizojnë shkallën më të ultë të punësimeve për staf (SHPS 20:1), ndjekur nga rajoni i Mitrovicës (SHPS 25:1). Performancë shumë më të mirë rajonale për vitin 2015 sa i përket SHPS-së ishte raportuar nga zyrtarët e punësimit në rajonet e Prizrenit dhe Gjakovës (58:1 dhe 53:1).

3. MASAT AKTIVE NË TREGUN E PUNËS

Gjatë periudhës raportuese janë përdorur një grup i caktuar i masave aktive të punësimit me qëllim të zbutjes së papunësisë. Mirëpo duke pasur parasysh së Aftësimi Profesional ofrohet nga 8 Qendrat e Aftësimi Profesional, që operojnë nën ombrellën e DPP-së dhe është një prej masave aktive më prioritare e cila merr pjesë me përqindjen më të lartë proporcionale me 56.5% të të gjitha masave aktive të punësimit. Aftësimi Profesional do të pasqyrohet ndaras nga masat e tjera aktive të tregut të punës. Mirëpo do të përdoret e njëjta metodologji dhe mënyrë analitike.

Tabela. 20. Masat Aktive në Tregun e Punës

MATP sipas llojit	Total	%
Aftësim Profesional	4055	56.5%
Punë Publike	1865	26.0%
Subvencionim i Pagave	498	6.9%
Vetë Punësimi	49	0.7%
Praktikant	188	2.6%
Trajnim në Punë	281	3.9%
Trajnim i kombinuar me Kompani ⁸	244	3.4%
Total	7180	100%


3.1. Aftësimi Profesional

Aftësimi profesional përfshin dy nënmasa, si: (i) Trajnimi institucional në Qendrat e Aftësimi Profesional dhe (ii) Trajnimi i kombinuar (QAP dhe kompani).

- (i) Trajnimi institucional nënkupton trajnimi që ofrohet nga 8 Qendrat e Aftësimi Profesional (QAP) që operojnë nën ombrellën e DPP-së. Qendrat për Aftësim Profesional (QAP) ofrojnë trajnime për punëkërkesit për një profesion të caktuar falas duke u fokusuar në aplikimin e shkathtësive dhe njohurive praktike duke përdorur mësimin në klasë si dhe në kabinete të ndryshme. Qëllimi i trajnimeve institucionale është që të mundësojnë një ngritje ose adaptim të njohurive profesionale, shkathtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për performancë efikase brenda një profesioni. Duke i mundësuar pjesëmarrësve që të marrin njohuri shtesë, shkathtësitë dhe aftësitë për të kryer punë efikase, trajnimet në QAP-e në këtë mënyrë synojnë të rrisin perspektivën e pjesëmarrësve në punësim ose ruajtjen e punësimit të tyre.
- (ii) Qendrat e Aftësimi Profesional do të identifikojë kompanitë për bashkëpunim dhe me marrëveshje mirëkuptimi me bizneset, do të aplikojnë trajnim të kombinuar, ku disa module zhvillohen në qendër dhe modulet e tjera të ndërlidhura me pjesën praktike të finalizimit të produktit zhvillohet në kompani.

⁸ Trajnimi i Kombinuar me Kompani – është trajnimi i cili një pjesë zhvillohet në QAP ndërsa pjesa tjetër në Kompani.

Gjatë vitit 2015, 4055 të papunë kanë hyrë në trajnime, të shpërndarë në më shumë se 30 profesione të Qendrave të Aftësimit Profesional. Nëse krahasohet me vitin 2014 numri i pjesëmarrësve në Aftësim Profesional është rritur prej 18.6%.



Duke iu referuar numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në AP (përkatesisht hyrjet) në vitin 2015 me numrin e përgjithshëm të të papunëve të regjistruar gjatë kësaj kohe, rezulton në shkallë trajnimi 12 mujore (SHT) prej rreth 3.6%, duke treguar rritje krahasuar me vitin paraprak sa ishte SHT me 1.26%.

Duke iu referuar numrit të gjithmbarshëm të hyrjeve në vitin 2015, numri i të certifikuarve nga AP-ja (3298), rezulton në Shkallë Certifikimi (SHC) prej rreth 81.3%, duke treguar ngritje relative nga SHC prej 63% sa ishte në vitin paraprak.

3.1.1. Aftësimi profesional sipas kualifikimeve


Tabela 16: Aftësimet profesionale sipas kualifikimeve

Kualifikimet	Hyrje në Aftësime	%	Papunësia	ShT ⁹	Të Certifikuarit	ShÇ ¹⁰
Pa Kualifikuar	3	0.1%	68395	0.0%	3	100.0%
Shkollë fillore	1041	25.7%	17500	5.9%	769	73.9%
Shkollë e mesme	2398	59.1%	21006	11.4%	2078	86.7%
Universitet	600	14.8%	5052	11.9%	435	72.5%
Master	13	0.3%	226	5.8%	13	100.0%
Dr. shkencave	-	-	-	-	-	-
Total	4055	100%	112179	3.6%	3298	81.3%

⁹ Shkalla e Trajnimit – është numri i hyrjeve në trajnime ne raport me papunesin e regjistruar.

¹⁰ Shkalla e Çertifikimit – është numri i të certifikuarve ne raport me numrin e hyrjeve ne trajnime.

Sa u përket niveleve të ndryshme të kualifikimeve, shifrat e raportuara gjatë vitit 2015, në mënyrë disproporcionale, tri grupet e kualifikimit më të lartë ende realizojnë në mënyrë propocionale përqindje shumë më lartë sesa tri grupet me kualifikim më të ulët, të cilat mbesin shumë më poshtë.



Numri me i madh i hyrjeve në aftësi profesionale është

me shkollë të mesme me 59.1%, pastaj me shkollë fillore me 25.7% (shih. tab. 16)

Shkalla e certifikimit në mënyrë mbi proporcionale për kategoritë me universitet dhe të pakualifikuar është realizuar 100%, pastaj me shkollë të mesme me (86.7%) ndërsa kategoritë e tjera janë nën mesataren kosovare prej 81.3% të certifikimeve.

3.1.2. Aftësimi profesional sipas grup-moshës


Qendrat e Aftësimi Profesional edhe gjatë viti 2015 i kanë dhënë rëndësi grup-moshës së të rinjve, që në mënyrë proporcionale grup-mosha 15-24 merr pjesë me 44.6%, pasuar nga grup-mosha tjetër 25-39 me 42.5%. Kurse grup-mosha 40-54 dhe 55+ marrin pjesë me 12.1%, respektivisht me 0.8%.

Tabela 17: Aftësimet profesionale sipas grup-moshës

Grup-mosha	Hyrje në Aftësi	%	Papunësia	ShT	Të Certifikuarit	ShÇ
15-24	1807	44.6%	10603	17.0%	1497	82.8%
25-39	1723	42.5%	53983	3.2%	1365	79.2%
40-54	492	12.1%	37685	1.3%	411	83.5%
55+	33	0.8%	9908	0.3%	25	75.8%
Total	4055	100%	112179	3.6%	3298	81.3%

Shkalla e Trajnimit sipas grup-moshës 15-24 arrijnë 17.0% e ndjekur nga grup-mosha tjetër 25-39 me 3.2%. Ndërsa grup-moshat e tjera më të vjetra marrin pjesë me shkallë më të ultë të pjesëmarrjes.

Sikurse në vitet e tjera edhe gjatë këtij viti shifrat aktuale konfirmojnë një prioritet të vazhdueshëm, që i jepet të rinjve të regjistruar si të papunë. Sa për të parë nga



diagrami (fig.20), ngjashëm me shkallët e punësimit gjithashtu edhe shkallët e trajnimit janë në korrelacion në mënyrë të përsëritshme me moshën.

Sidoqoftë, është evidente ngritja e përgjithshme e pjesëmarrjes në Aftësim Profesional me rreth 3.6%, krahasuar me vitin paraprak e cila ishte 2.1% duke iu referuar të gjitha grup-moshave.

Shkalla e Certifikimit të kandidatëve në mesataren kosovare arrijnë shifrën prej 81.3%, mirëpo grup-moshat 15-24 dhe 55-64 e tejkalojnë këtë mesatare, ndërsa dy grup-moshat e tjera mbesin nën vlerat mesatare kosovare të certifikimit.

3.1.3. Aftësimi Profesional sipas etnitetit

Aftësimi Profesional gjatë kësaj periudhe raportuese pasqyron diferencën mjaft të theksuar të shifrave në bazë të grupeve etnike. Shqiptarët përballen me tregues pozitiv të pjesëmarrjeve në Aftësim Profesional me 3750 pjesëmarrës apo 92.5% e të gjitha trajnimeve, pastaj serbët me 2.3% ose 92 pjesëmarrës, kurse komunitetet e tjera pakicë marrin pjesë me 5.3% ose 213 pjesëmarrës.


Tabela 18: Aftësimet Profesionale sipas etniteteve

Etnitetet	Hyrje në Aftësime	%	Papunësia	ShT	Të Certifikuarit	ShÇ
Shqiptar	3750	92.5%	99153	3.8%	3056	81.5%
Serb	92	2.3%	4319	2.1%	85	92.4%
Minoritetet tjera	213	5.3%	8707	2.4%	157	73.7%
Të Gjitha Minoritetet	305	7.5%	13026	2.3%	242	79.3%
Total	4055	100%	112179	3.6%	3298	81.3%

Shkalla e trajnimit në mesataren kosovare e cila gjatë këtij viti raportues është 3.6%, nxjerr në pah një ndikim të vogël mbi-proporcional të shqiptarëve me 3.8%. Mirëpo komunitetet e tjera në mënyrë nënproporcionale janë nën mesataren kosovare, ku serbët marrin pjesë me 2.1%, ndërsa minoritetet e tjera me 2.4%. kështu që të gjitha minoritetet marrin pjesë me 2.3% e cila përsëri është nën vlerat e mesatares kosovare.

Gjithashtu, duhet theksuar edhe shkalla e certifikimit për shqiptarët është pak mbi vlerën e mesatares kosovare prej 81.3%, mirëpo serbët marrin pjesë me 92.4% të certifikimeve e cila është dukshëm më lartë se mesatarja kosovare prej 81.3% (shih. tab. 18)

Fig.21: ShT sipas etniteteve



3.1.4. Aftësimi Profesional sipas gjinisë

Hyrjet në Aftësime Profesionale për 12 muaj sipas gjinisë, tregon se përqindja e femrave në pjesëmarrje është përafërsisht sikurse viteve tjera paraprake me 44%, ndërsa meshkujt marrin pjesë me 56% gjatë këtij viti raportues.

Tabela 19: Aftësimet Profesionale sipas gjinisë

Gjinia	Hyrje në Aftësime	%	Papunësia	ShT	Te Certifikuarit	ShÇ
Femra	1786	44.0%	48960	3.6%	1407	78.8%
Meshkuj	2269	56.0%	63219	3.6%	1891	83.3%
Total	4055	100%	112179	3.6%	3298	81.3%

Shkalla e trajnimit për gjininë femërore dhe mashkullore është e njëjtë me 3.6%, njëjtë sikurse mesatarja kosovare. Sa i përket certifikimit të pjesëmarrësve në Aftësim Profesional, gjinia femërore arrin shifrat prej 78.8% e cila është pak më ultë se mesatarja kosovare, ndërsa certifikimi i meshkujve prej 83.3% është mbi vlerat proporcionale të mesatares kosovare dhe është dukshëm më mirë se gjinia femërore.

3.1.5. Aftësimi Profesional sipas rajoneve


Aftësimet Profesionale (AP) sipas rajoneve, pasqyron rezultate të ndryshme, rajoni i Prizrenit në mënyrë proporcionale dominon me 28% ose 1134 pjesëmarrës kundrejt rajoneve tjera. Pas këtij rajoni renditet Rajoni i Pejës me 18.6% ose 754 pjesëmarrës në trajnime.

Tabela 20: Aftësimet profesionale sipas rajoneve

Rajonet	Hyrje në Aftësime	%	Papunësia	ShT	Të Certifikuarit	ShÇ
Ferizaj	399	9.8%	13723	2.9%	361	90.5%
Gjakovë	325	8.0%	12394	2.6%	182	56.0%
Gjilan	265	6.5%	14050	1.9%	180	67.9%
Mitrovicë	508	12.5%	16441	3.1%	455	89.6%
Pejë	754	18.6%	10738	7.0%	513	68.0%
Prishtinë	670	16.5%	24966	2.7%	644	96.1%
Prizren	1134	28.0%	19867	5.7%	963	84.9%
Total	4055	100%	112179	3.6%	3298	81.3%

Rajoni me pjesëmarrjen më të ultë është Gjilani me 6.5% ose 265 pjesëmarrës, pasojnë rajoni i Gjakovës me 8% ose 325 pjesëmarrës.

Duke iu referuar kapaciteteve të realizuara të Aftësimit Profesional në shifra absolute me mesataren e mbledhur të të regjistruarve si të papunë në rajonet e ndryshme, shkalla më e lartë e trajnimit (SHT) në vitin 2015 ishte arritur në rajonin e Pejës me 7.0%, pasuar nga rajoni i Prizrenit me 5.7%. Ndërsa shkalla e trajnimit më e ultë pasqyron rajonin e Gjilanit me 1.9%.



Zhvillimi i Shkallës së Trajnimit vë në dukje një rritje të vazhdueshme të kontrasteve sa i përket pjesëmarrjes në Aftësimin Profesional, përkatësisht kapaciteteve.

3.2. MASAT E TJERA AKTIVE NË TREGUN E PUNËS

Masat e tjera aktive në tregun e punës do të pasqyrohen tash e tutje si pjesë e veçantë e këtij raporti, duke ditur rëndësinë shumë të madhe që kanë këto masa për mbështetjen e papunësisë. Pra, masat aktive të punësimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në integrimin e personave të papunë në tregun e punës. Përmes masave aktive janë ndërmjetësuar një numër i konsiderueshëm i punësimit të personave të papunë, si dhe një numër prej tyre janë referuar në aftësi profesionale. Referimi në trajnime afatshkurtra ka ndikuar ndjeshme në zhvillimin e shkathtësive individuale për secilin të papunë i cili ka marrë shërbime nga SHPP-të. Masat e tjera aktive në tregun e punës të paraqitura në këtë pjesë të raportit, janë: (i) trajnim në punë (ii) stazhieri/praktikë në punë (iii) subvencionim për punësim (iv) vetëpunësim (v) punë publike.

- (i) Trajnim në Punë (TnP), nënkupton trajnimin nga një punëdhënës që i është ofruar punëkërkuarit gjatë angazhimit në punën produktive e cila zhvillon njohuri ose aftësi thelbësore për kryerjen e një pune specifike me një performancë adekuate. Pra, objektivi kryesor i TNP-ja është për të rritur aftësitë dhe perspektivat e punëkërkuarit për punësim. TNP-ja është një masë e tregut të punës me qëllim që pjesëmarrësve t'i jepen aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer një punë të veçantë në kuadër të punës dhe mjedisit të punës. TNP-ja mbështet punëkërkuarit të kenë qasje në mundësitë e trajnimit dhe të kontaktojnë me punëdhënësit në mënyrë që të përmirësojnë mundësitë e ardhshme për punësim dhe të fitojë një vend pune.

- (ii) Praktikë në Punë (PnP) nënkupton një masë të tregut të punës që synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë për të hyrë në fushën e caktuar të karrierës. Pra, objektivi kryesor i PNP-së është për të rritur aftësitë dhe perspektivat e sapo diplomuarit për punësim. PNP-ja është një masë e tregut të punës me qëllim që pjesëmarrësve t'iu jepen aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer një punë të veçantë në kuadër të punës dhe mjedisit të punës. PNP-ja mbështet të sapo diplomuarit që të kenë qasje në mundësitë e trajnimit dhe të kontaktojnë me punëdhënësit në mënyrë që të përmirësojnë mundësitë e ardhshme për punësim dhe të fitojnë një vend pune. Promovimi i punësimit të punëkërkuarve të para të punës që kanë për qëllim të fillojnë një punë të përshtatshme në llojin e tyre të arsimit, dhe të cilët kanë përfunduar shkollën profesionale të mesme, apo arsimin universitar. Masa ka për qëllim rritjen e perspektivave të punësimit për të papunët që kërkojnë punë për herë të parë.
- (iii) Subvencioni për Punësim (SpP) nënkupton një masë të tregut të punës që synon të krijojë mundësi punësimi për punëkërkuarët duke subvencionuar punëdhënësit që t'i rekrutojnë ata në bazë afatgjatë. Pjesëmarrësit në skemën e SPP-së pritet të mbeten në vend pune pas përfundimit të periudhës së subvencionimit. Këto janë transferat e drejtpërdrejta për punëdhënësit për t'i inkurajuar ata që të punësojnë grupet e caktuara me vështirësi për të gjetur punë. Subvencionet për punësim mund të ndihmojnë punëdhënësit për të zgjeruar biznesin e tyre dhe të punësojnë staf të ri, i cili do të ndihmojë për të krijuar më shumë vende pune.
- (iv) Qëllimi kryesor i masës për vetëpunësim është që të ofrojë mundësi për të papunësuarit e regjistruar për të filluar një aktivitet biznesi. Programi i vetëpunësimit është një masë e tregut të punës e cila ndihmon të papunësuarin për nisjen e një biznesi, ose ofrimi i trajnimit dhe këshillimit të vetëpunësuarve për të zhvilluar dhe menaxhuar një biznes dhe mbështetjen financiare për të ndihmuar të papunësuarit për të nisur një aktivitet biznesi. Masa për vetëpunësim ka për qëllim adresimin e papunësisë përmes vetëpunësimit dhe në këtë mënyrë duke krijuar vende të reja pune në kompanitë e vogla.
- (v) Punët publike ofrojnë punësim afatshkurtër duke përmirësuar infrastrukturën lokale. Qëllimi i programeve për punët publike janë gjenerimi i punësimit të përkohshëm për të papunësuarit të regjistruar përmes implementimit të projekteve intensive që absorbojnë fuqi punëtore si dhe mirëmbajtja dhe rehabilitim të pasurive (aseteve) komunale dhe të hapësirave publike.

Gjatë vitit 2015 janë aktivizuar 3.125 të papunë në masat e tjera aktive të punësimit. Të gjitha këto masa janë realizuar brenda periudhës raportuese. Shkalla e aktivizimit në masat aktive të tregut të punës ka qenë 2.8%.

3.2.1. Masat aktive në tregun e punës sipas kualifikimeve


Masat aktive të punësimit sa i përket niveleve të ndryshme të kualifikimeve, shifrat e raportuara gjatë vitit 2015, në mënyrë disproporcionale, pasqyrojnë rezultate të ndryshme ku grupet me kualifikim terciar marrin pjesë më pak sesa grupet e tjera.

Tab. 21: MATP sipas kualifikimit

Kualifikimet	MATP	%	Papunësia	ShA ¹¹
Pa Kualifikuar	563	18.0%	68395	0.8%
Shkolle fillore	902	28.9%	17500	5.2%
Shkolle e mesme	1378	44.1%	21006	6.6%
Universitet	266	8.5%	5052	5.3%
Master	16	0.5%	226	7.1%
Dr. shkencave	0	0.0%	-	-
Total	3125	100%	112179	2.8%

Në mënyrë proporcionale numri më i madh i aktivizimit në masat aktive të punësimit është me shkollë të mesme 44.1% ose me 1378 përfitues, pastaj më shkollë fillore me 28.9% ose 902 persona, si dhe të pakualifikuarit me 18% ose 563 persona, (shih. tab. 21).

Mesatarja e aktivizimit është 2.8%, ndërsa



shkalla e aktivizimit për kategoritë me master, universitet, shkollë të mesme dhe shkollë fillore është mbi këtë vlerë. Kurse kategoria e të pakualifikuarve në mënyrë nen proporcionale është me 0.8% të shkallës së aktivizimit. Duhet theksuar se numri më i madh i të papunëve të regjistruar i përket kësaj kategorie me 68.395 persona të regjistruar si të papunë.

¹¹ Shkalla e Aktivizimit - është numri i ndërmjetësimeve në masat e tjera aktive të punësimit në raport me papunësinë e regjistruar

3.2.2. Masat Aktive në Tregun e Punës sipas grup-moshës


Të rinjtë janë kategoria më përfituese sa i përket mbështetjes përmes masave aktive të punësimit. Gjatë viti 2015 në mënyrë proporcionale grup-mosha 15-24 merr pjesë me 37.5%, pasuar nga grup-mosha tjetër 25-39 me 36.1%, si dhe grup-mosha 40-54 me 22.45 ose 699 përfitues. Kurse grup-mosha 55+ marrin pjesë me vetëm 4% ose 125 persona kanë marrë mbështetje.

Tab. 22. MATP sipas grup-moshës

Grup-mosha	MATP	%	Papunësia	SHA
15 - 24	1172	37.5%	10603	11.1%
25 - 39	1129	36.1%	53983	2.1%
40 - 54	699	22.4%	37685	1.9%
55+	125	4.0%	9908	1.3%
Total	3125	100%	112179	2.8%

Shkalla e Aktivizimit sipas grup-moshës 15-24 arrijnë në 11.1%, ndërsa grup-moshat e tjera si 25-39 me 2.1%, dhe më pas vijnë grup-moshat 40-54 dhe 55+, të cilat marrin pjesë me shkallë më të ultë të aktivizimit, bile nën vlerat mesatare, e cila në shkallë vendi është 2.8%.

Përmes masave aktive të punësimit shifrat aktuale konfirmojnë një prioritet të vazhdueshëm, që i jepet të rinjve. Dallimi është shumë i madh në aktivizim krahasuar me moshat e tjera më të vjetra.



3.2.3. Masat Aktive në Tregun e Punës sipas etnitetit

Gjatë kësaj periudhe raportuese rezultatet paraqesin diferenca mjaft të theksuara në bazë të grupeve etnike. Në mënyrë proporcionale shqiptarët rezultojnë me tregues mjaft të lartë me 76.6% të pjesëmarrjes në masat aktive të punësimit. Ndërsa grupet e tjera etnike si serbët

Tab. 23. MATP sipas etnitetit

Kualifikimi	MATP	%	Papunësia	SHA
Shqiptar	2394	76.6%	99153	2.4%
Serb	151	4.8%	4319	3.5%
Minoritetet e tjera	580	18.6%	8707	6.7%
Gjithë Minoritetet	731	23.4%	13026	5.6%
Total	3125	100.0%	112179	2.8%

marrin pjesë me 4.8% ose 151 përfutues dhe minoritetet e tjera marrin pjesë me 18.6% ose 580 pjesëmarrës.

Shkalla e Aktivizimit në mesataren kosovare e cila gjatë këtij viti raportues është 2.8%, nxjerr në sipërfaqe në mënyrë

mbi proporcionale minoritetet e tjera me 6.7%. Po ashtu, komuniteti serb merr pjesë me 3.5% të shkallës së aktivizimit e cila është dukshëm mbi mesataren kosovare prej 2.8%. Shkalla e Aktivizimit në masa aktive për shqiptaret është nën vlerat mesatare prej 2.4%.




3.2.4. Masat Aktive në Tregun e Punës sipas profesionit

Masat aktive të punësimit bazuar në ndarjen profesionale në mënyrë proporcionale shkojnë më së shumti për profesione elementare me 43.5%, aty ku është edhe koncentrimi më i madh i papunësisë së regjistruar, pastaj tek zejtarët dhe punëtorët e ngjashme me 16.2% si dhe teknikët dhe profesionet e ngjashme me 10.3%.

Tab. 24. MATP sipas profesioneve

Profesioneve	MATP	%	Papunësia	SHA
Ligjvënësit, zyrtarët e lartë dhe menaxherët	23	0.7%	598	3.8%
Profesionistët	290	9.3%	6335	4.6%
Teknikët dhe profesionistët e ngjashëm	321	10.3%	8064	4.0%
Nëpunësit	146	4.7%	2397	6.1%
Punëtorët e shërbimeve dhe punëtorët e shitjes në dyqan dhe treg	288	9.2%	4767	6.0%
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	137	4.4%	1107	12.4%
Zejtarët dhe punëtorët e ngjashëm	506	16.2%	6983	7.2%
Operatorët dhe montuesit e pajisjeve dhe makinave	55	1.8%	932	5.9%
Profesionet elementare	1,359	43.5%	80996	1.7%
Forcat e armatosura	-	-	-	-
Total	3,125	100%	112179	2.8%

Kategoria
profesionale
e cila ka
përfutur më
së paku janë
Ligjvënësit,
zyrtarët e



lartë dhe menaxherët me 0.7%. Shkalla e aktivizimit në masa aktive të punësimit është arritur në mënyrë mbi proporcionale për *punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkari* me 12.4%, pastaj *zejtarët dhe punëtorët e ngjashëm* me 7.2%, ndërsa me shkallën e aktivizimit më të ultë janë ballafaquar *profesionet elementare* me 1.7% (shih fig. 26).

3.2.5. Masat Aktive në Tregun e Punës sipas gjinisë

Pjesëmarrja në masa aktive të punësimit për 12 muaj sipas gjinisë, tregon se përqindja e femrave është përafërsisht me 25.1 ose 784 persona, ndërsa meshkujt marrin pjesë me 74.9% ose 2341 persona.

Tab. 25. MATP sipas gjinisë

Grup-mosha	MATP	%	Papunësia	SHA
Femra	784	25.1%	48960	1.6%
Meshkuj	2341	74.9%	63219	3.7%
Total	3125	100%	112179	2.8%

Shkalla e aktivizimit prej 1.6% për gjininë femërore, po ashtu mbetet nën vlerat e mesatares kosovare e cila është 2.8%, ndërsa për gjininë mashkullore shkalla e aktivizimit është dukshëm më e lartë dhe mbi proporcionale në 3.7%.

3.2.6. Masat Aktive në Tregun e Punës sipas rajonit

Masat Aktive në Tregun e Punës (MATP) sipas rajoneve, pasqyron rezultate të ndryshme, ku rajoni i Prishtinës në mënyrë proporcionale dominon me 28.2% ose 882 pjesëmarrës kundrejt rajoneve tjera. Pas këtij rajoni renditet Rajoni i Gjilanit me 21.6% ose 674 pjesëmarrës.

Tab. 25. MATP sipas profesioneve

Rajonet	MATP	%	Papunësia	SHA
Ferizaj	262	8.4%	13723	1.9%
Gjakovë	225	7.2%	12394	1.8%
Gjilan	674	21.6%	14050	4.8%
Mitrovicë	499	16.0%	16441	3.0%
Pejë	242	7.7%	10738	2.3%
Prishtinë	882	28.2%	24966	3.5%
Prizren	341	10.9%	19867	1.7%
Total	3,125	100%	112179	2.8%

Rajoni me pjesëmarrjen më të ultë në masat aktive të punësimit është Gjakova me 7.2% ose 225 pjesëmarrës, pasojnë rajoni i Pejës me 7.7% ose 242 pjesëmarrës dhe Ferizaj me 8.4% ose 262 pjesëmarrës.

Duke iu referuar shkallës së aktivizimit të realizuara në masa aktive të punësimit dominon rajoni i Gjilanit me 4.8% dhe atë mbi vlera mesatare të Kosovës. Mandej rajoni i Mitrovicës me 3.0%, dhe i Prishtinës me 3.5%.



Ndërsa rajonet të cilat kanë realizuar shkallën më të ultë janë rajoni i Prizrenit me 1.7%, pastaj rajoni i Gjakovës me 1.8% dhe i Ferizajt me 1.9%.

Aneks A: Projektet e realizuara në kuadër të reformës në SHPP

Profilizimi i të papunësuarve - Profilizimi me reformat e ndërmarra në vitin 2015 është bërë pjesë integrale e qasjes së re të ofrimit të shërbimeve të punësimit. Profilizimi apo segmentizimi i punëkërkuarit, është procedurë e identifikimit dhe caktimit të të papunësuarve në kategori të ndryshme në mënyrë që të dallohen ata që mund të gjejnë punë me lehtësi nga ata të cilët kanë më shumë vështirësi. Gjatë procesit të intervistimit i papunësuar regjistrohet në SIMP, si dhe do të segmentohet ose profilizohet në njërin prej tre nën-grupeve në vijim: (i) Grupi me rrezik të ulët për t'u bërë i papunë afatgjatë (PA); (ii) Grupi me rrezik të mesëm për t'u bërë i PA; (iii) Grupi me rrezik të lartë për t'u bërë i PA.

Shërbime online të punësimit – MPMS-ja do të lansojë platformën online ku të gjithë punëkërkuarit dhe punëdhënësit vetëm me një regjistrim mund të përdorin të gjitha shërbimet e punësimit të ofruara në këtë platformë. Të gjithë ata punëkërkuar, të cilët janë përdorues të shërbimeve të ofruara në platformën online por jo të shërbimeve të ofruara në ZP, do të mbahen në listën e veçantë për 'punëkërkuarit e regjistruar'. Punëkërkuarit (ose punëdhënësit) pas regjistrimit dhe krijimit të profilit të tyre si punëkërkuar (ose si punëdhënë) do të kenë qasje në shërbimet e ofruara përmes internetit si të tilla shqyrtimi i vendeve të lira të punës (ose shpallje e vendeve të reja për punëdhënë), marrja e informatave për konkursat e shpallura, aplikimi i drejtpërdrejt në vendet e lira të punës (ose shqyrtimi i aplikimeve për punëdhënë), rishikimi dhe aplikimi për trajnimet e ofruara nga QAP-i, etj. Shërbimet shumëkanalëshe mundësojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe automatike.



Sistemi i brendshëm i trajnimit - Ky sistem është i zhvilluar në web dhe si aplikacion do të shërbejë për të gjithë stafin e zyrave të punësimit dhe aftësimin profesional. Përveç trajnimeve që do të ofrohen për të iniciuar modelin e ri të ofrimit të shërbimeve, varësisht nga numri i stafit që dedikohet për divizionin për burime njerëzore, do të shqyrtojë mundësinë ta funksionalizojë platformën për Sistem të Brendshëm të Trajnimit (SBT), si dhe të planifikojë dhe organizojë trajnimet për të gjithë stafin e Zyrave të Punësimit nga kurset të cilat janë të vendosura në SBT, moduleve dhe funksioneve të stafit për të ngritur nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Zyrat e Punësimit.

Aneks B: Projektet e realizuara gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 Departamenti i Punës dhe Punësimi (DPP) ka vazhduar me hartimin dhe realizimin e dokumenteve nga fusha e punës dhe punësimi si dhe aftësimeve profesionale.

DPP-ja ka monitoruar, mbikëqyr, vlerësuar dhe realizuar politikat e punësimi dhe aftësimeve profesionale përmes Divizionit të Punësimi dhe Divizionit të Aftësimeve Profesionale. Ka vazhduar të sigurojë dhe ofrojë këshilla profesionale, dhe ka bërë monitorimin e aktiviteteve të divizioneve dhe të shërbimeve të punësimi e të aftësimi profesional në nivel të Kosovës.

DPP-ja ka nxitur bashkëpunimin brenda dhe jashtë Kosovës në zhvillimin e politikave të punësimi dhe aftësimeve profesionale. Ka ofruar mbështetje në realizimin e planeve dhe programeve të punësimeve dhe aftësimeve profesionale. Është angazhuar për mbështetje dhe bashkëpunim të plotë dhe efektiv ndërmjet të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me sferën e punës dhe punësimi.

DPP-ja ka nxitur dhe zhvilluar bashkëpunimin me ndërmarrjet që kanë ndikim në zhvillimin e tregut të punës në nivel të Kosovës dhe jashtë saj. Ka hartuar buxhetin në nivel të Departamentit të Punës dhe Punësimi. Ka bërë planifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe ka bërë rekrutimin e personelit në nivel të Departamentit të Punës dhe Punësimi.

Departamenti i Punës dhe Punësimi përmes Divizionit të Monitorimit dhe Koordinimit të Zyrave të Punësimi, Divizionit të Politikave të Punësimi, ka vazhduar të bëjë realizimin e masave aktive të punësimi përmes shtatë (7) Qendrave Regjionale për Punësim me njëzetetë (23) Zyra Komunale për Punësim, dhe 6 Nënzyra Komunale për Punësim, 8 Qendrave për Aftësime Profesionale.

Për realizimin e politikave aktive të punësimi dhe ngritjen e punësimi, Divizioni i Punës dhe Punësimi ka bashkëpunuar ngushtë në realizimin e një numri të caktuar të projekteve me MBPZHR-në, APK-në, MTPT-në, UNDP-në, Kosvet VI, BB-në, komunat, dhe me institucionet e tjera vendore dhe të jashtme.

Programet dhe projektet aktive në tregun e punës:

1. Projekti **“Pyllëzimi vjeshtor”**, në bashkëpunim me APK-në. Kanë përfituar 184 punëkërkues me pagë mujore 250€ për periudhën dyzetepesë (45) ditëshe. Projekti u bashkëfinancua me 44,250.00 € nga APK-ja dhe 24,750.00 € nga MPMS-ja.
2. Projekti **“Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura”**, në bashkëpunim me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK). Përfituan njëqindeshtatëdhjetenjë (171) punëkërkues për 45 ditë dhe vazhdoi projekti me 24 përfitues për 6 muaj me pagë mujore 250 €. Vlera e përgjithshme e projektit është 100,125.00€ nga MPMS-ja.

3. Projekti **“Sanimi i gjendjes së pyjeve nga zjarret, aktivitetet silvikulturore, rrallime”**, në bashkëpunim me APK-në, përfituan gjashtëqindpesëdhjetë (650) punëkërkues me pagë mujore 250€ për dy muaj. Vlera e projektit 325,000.00€ nga MPMS-ja.
4. Projekti **“Shuarja e zjarreve”**, në bashkëpunim me APK-në. Në këtë projekt përfituan njëqindnjëzet (120) punëkërkues me pagë mujore 250 € për katër (4) muaj. Projekti u financua nga APK-ja në vlerë 120,000.00€.
5. Projekti, **“Kultivimi i Fidanëve në Fidanishten e APK-së”**, në bashkëpunim me APK-në. Përfituan njëzet (20) përfitues për nëntë (9) muaj, me pagë mujore 250 €. Projekti është bashkëfinancuar gjashtë (6) muaj nga APK-ja dhe tre (3) muaj nga MPMS-ja. Vlera e përgjithshme e projektit 45,000.00 €.
6. Projekti, **“Praktika në Punë 1 në Sektorin Publik & Privat”**, në këtë projekt përfituan njëqindetridhjetë (130) praktikantë, me pagë mujore 250€ për tetë (8) muaj. Projekti u financua nga MPMS-ja, në vlerë 260,000.00 €.
7. Projekti, **“Praktika në Punë 2 në Sektorin Publik & Privat”**, në këtë projekt përfituan pesëdhjetë (50) praktikantë, me pagë mujore 250 € për gjashtë (6) muaj. Projekti u financua nga MPMS-ja në vlerë 75,000.00 €.
8. Projekti, **“Praktikantë në Zyrat e Punësimit”**, përfituan njëzetë (20) praktikantë me pagë mujore 250 € për nëntë (9) muaj. Projekti u financua nga MPMS-ja në vlerë prej 45,000.00 €.
9. Projekti, **“Praktikantë në QPS”**, përfituan dyzetë (40) praktikantë me pagë mujore 250€ për nëntë (9) muaj. Financuar nga MPMS-ja në vlerë 90,000.00 €.
10. Projekti, **“Praktikantë në DILFD”**, (Departamenti i Invalidëve të Luftës dhe Familjeve të Dëshmorëve). Në këtë projekt përfitojnë njëzetë (20) praktikantë me pagë mujore 250 €, për dy muaj. Projekti financohet nga MPMS-ja në vlerë 20,000.00 €.
11. **Punë Praktike në Infermieri në Cyrih-Zvicër** – MPJ-ja ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Qendrën për Përkujdesje të Personave të Moshuar. Numri i aplikacioneve ka qenë 81, ndërsa prej tyre janë përzgjedhur dhe janë ndërmjetësuar 7 persona, ku kohëzgjatja ka qenë 4 muaj.

Aneks C: Vërtetimet për lajmërimin e punës për shtetas të huaj “30, 60, 90 ditë”

Që nga shtatori i vitit 2013 është në fuqi Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili rregullon hyrjen, qëndrimin si dhe punësimin e të huajve.

Vërtetimi për lajmërimin e punës për të huaj, rregullon angazhimin e të huajve në shërbimet në kohëzgjatje deri më 90 ditë brenda vitit kalendarik, kjo është rregulluar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt si dhe të Udhëzimit Administrativ 01/2014 i cili rregullon Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit për Lajmërimin e Punës.

C1. Vërtetime për lajmërimin e punës sipas moshës

Gjatë këtij viti janë lëshuar 131 Vërtetime për Lajmërimin e Punës për Shtetas të Huaj, ku nga ky numër 18 vërtetime kanë qenë vazhdim.

Grup-mosha	Vërtetimi për Lajmërimin e Punës	%
20 - 25	3	2%
25-30	22	17%
30 - 40	59	45%
40 - 50	13	10%
50 -60	31	24%
60+	3	2%
Totali	131	100%

C2. Vërtetime për lajmërimin e punës sipas shtetësisë

Shtetasit të cilët janë pajisur me Vërtetim për Lajmërimin e Punës, e që janë në numër më të madh janë Maqedonas, Rumun, Turq dhe Polak të cilët përbëjnë 57% të numrit total të shtetasve në përgjithësi.

Shtetësia	Gjithsej	%
Amerikan	1	0.8%
Austriak	1	0.8%
B I H	1	0.8%
Bullgar	7	5.3%
Çek	4	3.1%
Francez	3	2.3%
Gjerman	4	3.1%

Grek	1	0.8%
Kanadez	1	0.8%
Kroat	7	5.3%
Maqedonas	29	22.1%
Polak	10	7.6%
Portugez	4	3.1%
Çek	1	0.8%
Rumun	22	16.8%
Serb	7	5.3%
Shqiptar	4	3.1%
Slovak	4	3.1%
Sloven	4	3.1%
Spanjoll	1	0.8%
Turq	14	10.7%
Ukrainas	1	0.8%
Total	131	100%

C3. Vërtetime për lajmërimin e punës sipas gjinisë

Shtetasit e huaj të pajisur me Vërtetim për Lajmërimin e Punës, nga numri total prej 131 personave, prej tyre 129 janë meshkuj dhe 2 persona kanë qene femra.

Aneks E: Të dhëna dhe diagrame për punësimin

Rajoni	Komuna	Papunësia	Stafi	Vendet e lira të punës	Punësimi i rregullt	Masat Aktive të Tregut të Punës	Aftësimi Profesional
Prishtinë		24966	22	2449	860	882	670
	Prishtinë	9114	12	868	419	189	
	Fushë-Kosovë	1651	1	389	85	145	
	Glllogoc	3447	1	214	128	17	
	Lipjan	3265	2	185	74	121	
	Novobërdë	962	1	197	16	111	
	Obiliq	1569	1	188	91	47	
	Podujevë	3693	2	378	46	241	
	Graçanicë	1265	2	30	1	11	
Prizren		19867	10	1949	520	341	1134
	Prizren	9238	5	1052	296	146	
	Rahovec	3474	1	412	66	72	
	Suharekë	3978	3	278	130	53	
	Dragash	3177	1	207	28	70	
Ferizaj		13723	10	1018	201	262	399
	Ferizaj	8919	5	719	108	144	
	Kaçanik	2497	1	83	15	3	
	Shtime	1192	2	127	77	40	
	Shtërpçë	1115	2	89	1	75	
Gjilan		14050	13	1343	437	674	265
	Gjilan	5667	6	821	171	433	
	Viti	4411	4	288	174	113	
	Kamenicë	3972	3	234	92	128	
Gjakovë		12394	12	1475	636	225	325
	Gjakovë	4909	7	854	376	142	
	Deçan	4790	4	279	157	5	
	Malishevë	2695	1	342	103	78	
Pejë		10738	12	1622	575	242	754
	Pejë	6718	8	1039	350	148	
	Istog	1504	2	255	60	80	
	Klinë	2516	2	328	165	14	
Mitrovicë		16441	14	1650	345	499	508
	Mitrovicë	6617	4	1004	78	207	
	Skenderaj	5834	2	306	141	61	
	Vushtrri	3797	3	257	125	78	
	Zveçan	42	1	9	1	19	
	Zubin Potok	72	2	18	0	30	
	Leposaviq	79	2	56	0	104	
Gjithsej		112,179	93	11,506	3,574	3,125	4,055

Aneks F: Të dhënat e Aftësimit Profesional sipas profesioneve

	Profesionet	Hyrje në Aftësime	Të Certifikuar	% ¹²
	Grand Total	4055	3319	81.8%
Prishtina	Total	670	644	96.1%
	Asistent Administrativ	72	71	98.6%
	Kontabilitet	28	33	117.9%
	Administrim Biznesi	56	52	92.9%
	Auto-elektrike	14	11	78.6%
	Teknologji Informative	26	23	88.5%
	Elektronik industriale	5	10	200.0%
	Ndërtimtari	50	44	88.0%
	Furrari	220	210	95.5%
	Pastiçeri	50	48	96.0%
	Servisim i pajisjeve të zyrës	34	37	108.8%
	Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	29	25	86.2%
	Instalues I ngrohjes qendrore	25	19	76.0%
	Vetëpunësim	61	61	100.0%
Ferizaj	Total	399	361	90.5%
	Kuzhinier	62	63	101.6%
	hotelieri	34	29	85.3%
	TIK	52	42	80.8%
	Saldimi	29	28	96.6%
	Zdrukthëtari	45	38	84.4%
	Mirëmbajtës objekti	28	21	75.0%
	instalime elektrike	65	62	95.4%
	AB	43	32	74.4%
	UK	20	22	110.0%
	Ngrohje qendrore	21	24	114.3%
Mitrovicë	Total	429	391	91.1%
	Kuzhinier	60	50	83.3%
	Saldimi	43	37	86.0%
	Zdrukthëtari	32	29	90.6%
	Tekstil	39	40	102.6%
	Ndërtimtari	64	57	89.1%
	TIK (Teknologji informative dhe e komunikimit)	76	62	81.6%
	Administrim Biznesi	70	67	95.7%
	Bazat e kompjuterit, Qendra Mobile -Skenderaj	45	49	108.9%
Doljani	Total	79	65	82.3%
	Kuzhinier	25	22	88.0%
	Saldimi	10	8	80.0%
	Administrim biznesi	16	13	81.3%

¹² Përqindja e të certifikuarave sipas profesioneve mund të jete mbi 100% për arsye se një numër i hyrjeve në trajnime barten nga viti paraprak (shembull: hynë në trajnime në Nëntor apo Dhjetor dhe e përfundojnë në Shkurt apo Mars të vitit vijues)

	Zdrukthëtari	15	11	73.3%
	tekstil (rrobaqepësi)	13	11	84.6%
Pejë	Total	754	533	70.7%
	Kuzhinier	149	132	88.6%
	Ndërtimtaria	158	125	79.1%
	Hidro-instalime	82	55	67.1%
	Elektro-instalime	42	21	50.0%
	Braille	12	6	50.0%
	Asistent administrate	114	59	51.8%
	Kontabilitet	48	25	52.1%
	Agrikulturë	43	24	55.8%
	Vetëpunësim / Ndërmarrësi	27	26	96.3%
	Administrim Biznesi	44	33	75.0%
	Zdrukthëtari	35	27	77.1%
Prizreni	Total	1134	963	84.9%
	Kuzhinier	138	100	72.5%
	Kamerier	97	76	78.4%
	Auto-elektrike	59	43	72.9%
	Saldimi	56	48	85.7%
	TIK	88	75	85.2%
	Administrim Biznesi	86	65	75.6%
	Ndërmarrësi	45	45	100.0%
	Floktari	330	299	90.6%
	Bazat e Kompjuterit/sh	12	12	100.0%
	Elektromekanik i Pajis. Amvis.	63	62	98.4%
	Mekanik i Hidrau. dhe pneumat.	36	31	86.1%
	Kamerier Dragash	20	14	70.0%
	Rrobaqepësi	30	30	100.0%
	Vetëpunësim	74	63	85.1%
Gjilani	Total	265	180	67.9%
	Zdrukthëtari	25	17	68.0%
	Saldimi	42	31	73.8%
	TI	75	47	62.7%
	Grafik Dizajn	31	29	93.5%
	Kontabilitet	47	26	55.3%
	Administrim Biznesi	17	17	100.0%
	Ndërmarrësi	28	13	46.4%
Gjakova	Total	325	182	56.0%
	Asistent administrativ	48	37	77.1%
	Kontabilitet	42	30	71.4%
	Saldimi	34	24	70.6%
	Instalues elektrik	106	42	39.6%
	Administrim biznesi	7	3	42.9%
	Ndërmarrësi	7	7	100.0%
	Kompjuter	25	13	52.0%
	Vetëpunësim	29	26	89.7%
	Men. nd. mikro dhe vogla	27	0	0.0%

Aneks G. Kërkesa për fuqi punëtore: Vendet e lira dhe ndërmjetësimet e rregullta në punësim

Vendet e Lira sipas sektorit / NACE

		2012	2013	2014	2015	Rritje
A	Bujqësi/ Pylltari	1149	605	996	296	-70.3%
B	Peshkatari	-	-	-	0	-
C	Xehetari	0	8	0	7	-
D	Prodhim	1030	712	764	1718	124.9%
E	Elektrikë / gaz / ujë	23	94	52	69	32.7%
F	Ndërtim Civil	1929	651	598	1537	157.0%
G	Tregti	1536	1063	971	1689	73.9%
H	Hotelier / Gastronomi	494	460	520	627	20.6%
I	Transport / Komunikacion	77	54	52	166	219.2%
J/K	Financa / Sigurime / etj.	25	27	37	357	864.9%
M	Arsim	207	341	242	197	-18.6%
N	Shëndetësi / Mbrojtje Sociale	136	1190	94	1131	1103.2%
O	Shërbime	2664	1734	2126	3675	72.9%
Q	OJQ / Organ. Ndërkombëtare	164	41	114	37	-67.5%
	Sektori Primar	1149	605	996	296	-70.3%
	Sektori Sekondar	2982	1465	1414	3331	135.6%
	Sektori Terciar	5303	4910	4156	7879	89.6%
	Të gjithë	9434	6980	6566	11506	75.2%

(Këto tabela paraqesin saktësisht punësimet e realizuara. Megjithatë një krahasim i të dy tabelave duhet të nxjerrë ende potenciale ekzistuese në fushën e procedimit të të dhënave dhe kuptimit të rrjedhës së punës.)

Ndërmjetësimet e rregullta në punësim sipas / NACE

		2012	2013	2014	2015	Rritje
A	Bujqësi/ Pylltari	1190	660	1075	112	-89.58%
B	Peshkatari	-	-	-	-	-
C	Xehetari	3	5	0	2	-
D	Prodhim	768	579	392	515	31.38%
E	Elektrikë / gaz / ujë	26	83	15	15	0.00%
F	Ndërtim Civil	1326	408	534	498	-6.74%
G	Tregti	1144	815	728	702	-3.57%
H	Hotelier / Gastronomi	307	240	282	298	5.67%
I	Transport / Komunikacion	75	41	42	98	133.33%
J/K	Financa / Sigurime / etj.	35	25	25	26	4.00%
M	Arsim	154	171	98	23	-76.53%
N	Shëndetësi / Mbrojtje Sociale	219	130	88	43	-51.14%
O	Shërbime	2388	1530	1361	1232	-9.48%
Q	OJQ / Org. Ndërkombëtare	57	42	27	10	-62.96%
	Sektori Primar	1190	660	1075	112	-89.58%
	Sektori Sekondar	2123	1075	941	1030	9.46%
	Sektori Terciar	4379	2994	2651	2432	-8.26%
	Të gjithë	7692	4729	4667	3574	-23.42%

Të regjistruarit me aftësi të kufizuara

	Papunësia	Punësimi	Shkalla Punësimit	Trajnime	SHT
Të gjithë	499	49	9.82%	23	4.61%
Meshkuj	338	34	10.06%	14	4.14%
Femra	161	15	9.32%	9	5.59%

Definicionet dhe Terminologjia

Të gjithë Kapitujt:

Me qëllim të identifikimit të një dallimi dhe interpretimi që del nga ky raport, definicionet dhe terminologjia që përdoren janë të shpjeguara në vijim:

- **Popullata** është popullsia që banon brenda territorit të Kosovës.
- **Popullata e moshës punuese** përmban një pjesë të popullsisë e cila i përket moshës 15-64 vjeçare, e orientuar në Ligjin ekzistues të Punës.
- **Punëkërkuessit** - janë të gjithë personat që kërkojnë punë duke përfshirë edhe personat që punojnë me orar të plotë apo gjysmë orari dhe personat që janë suspenduar përkohësisht nga puna.
- **Të papunët** i referohen – sipas definicioneve të ILO-s – personave që kanë moshë pune, të cilët janë:
 - a) Të papunë,
 - b) duke kërkuar punë, dhe
 - c) janë në dispozicion për punë.
- **Të Papunësuarit (e regjistruar)** – iu referohen personave të cilët janë të *regjistruar si të papunësuar* (Këta duhet të jenë persona të cilët janë pa punë, mirëpo janë në kërkim të punës, sidoqoftë, kjo kërkesë implementohet vetëm pjesërisht në Kosovë dhe në shumicën e vendeve tjera).
- **Të Papunët afatgjatë** janë personat, të cilët janë të regjistruar si të papunësuar për më shumë se 12 muaj: ky raport i referohet proporcionit të llogaritur të papunësisë afatgjate, e cila është nën kushtin [dalje<regjistrime] dhe [hyrje-regjistrime], në:

$$\text{- rastin më të keq} = \frac{[i \text{ papunësuar} - (dalje - hyrje)]}{i \text{ papunësuar}} * 100 \quad | \text{ nën kushtin e zbritjes së regjistrimeve.}$$

$$\text{- rastin më të mirë} = \frac{[i \text{ papunësuar} - (hyrje + dalje)]}{i \text{ papunësuar}} * 100$$

$$\text{- rastin më të keq} = \frac{[i \text{ papunësuar} - (hyrje - dalje)]}{i \text{ papunësuar}} * 100 \quad | \text{ nën kushtin e rritjes së regjistrimeve.}$$

- **Të Punësuarit** janë të identifikuar prej definicionit në vijim të ILO/EUROSTAT-it, si:

“Një person është i konsideruar si i punësuar nëse ai apo ajo ka bërë ndonjë punë për pagë apo profit. ... Vetë të punësuarit janë po ashtu të konsideruar që janë duke punuar, nëse (personi) ,,punon në afarizmin e tij, praktikë profesionale apo fermë për qëllime të përfitimit të profitit,,

shpenzon kohë në operimin e afarizmit ,, është nën proces të themelimit të një afarizmi, ... Një punëtor i papaguar është thënë të jetë duke punuar nëse puna kontribuon direkt tek një afarizëm, fermë apo praktikë profesionale e pronësuar apo e drejtuar prej një anëtarë në lidhje me të njëjtit shtëpimbajtës”.

Termi “i punësuar” nënkupton personat me punësim të rregullt, të vetëpunësuarit (duke përfshirë bizneset e vogla – dhe pronarët e fermës), punëtorët e fermës, anëtarët e familjes që kontribuojnë (p.sh. në shitore dhe ferma) dhe – brenda gjithë asaj – nën – persona të punësuar: ndokush, që është më i vjetër se 15 vjet dhe – që punon për qëllim fitimi profit apo të ardhura (duke përfshirë edhe ata që nuk janë të suksesshëm të arrijnë një gjë të tillë).

- **Popullata Aktive** përbëhet prej: të regjistruarve si të papunë plus të punësuarit.
- **Shkalla e Papunësisë** përkatësisht shkalla e regjistrimit të papunësisë është proporcioni i të regjistruarve si të papunë prej popullatës ekonomike aktive.
- **Përpjesëtimi i Papunësisë** i referohet regjistrimit të papunësisë tek popullata me moshë të punës, përpjesëtimi i papunësisë këtu është i barabartë tek *përpjesëtimi i regjistruar i papunësisë* respektivisht tek *shkalla e regjistrimit*.
- **Grup moshat:** 15-24, 25-39, 40-54, 55-64.
- **Grupet Etnike:** Shqiptarë, Serbë, Malazez, Ashkalinj, Romë, Turq, Boshnjakë, të tjerë.

Për qëllime të analizave do të përdoret gjithashtu një klasifikim i shkurtër: shqiptarë, “të gjithë minoritarët”, serbë dhe “minoritete tjera” (pa serbë).

➡ **Sektorët sipas Aktiviteve** janë të orientuar në klasifikimin standard ndërkombëtar të aktiviteve ekonomike, NACE (Rev. I), por ende jo plotësisht i përshtatshëm:

- (A) bujqësi / pylltari
- (B) peshkim
- (C) minierë
- (D) prodhimtari
- (E) rrymë / gaz / ujë
- (F) ndërtim
- (G) tregti
- (H) hotelieri / gastronomi
- (I) transport / komunikim
- (J / K) financa / patundshmëri, etj.
- (M) arsimim
- (N) / mbrojtje sociale
- (O) shërbimet (OJQ)-të / organizatat

➡ **Sektorët Ekonomik:**

- ➡ Sektori primar (A-B)
- ➡ sektori sekondar (C-F),
- ➡ sektori terciar(G-O,Q).

➡ **Sektorët sipas Pronarit:**

- ➡ Sektori publik: qeveritar dhe institucionet e kontrolluara nga qeveria dhe ndërmarrjet.
- ➡ Sektori privat: individët privatë, fermat, bizneset dhe kompanitë.

KSNA/ISCED: Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit

➡ **SNKAE 0: Arsimimi parafillor:** Faza fillestare e instruksioneve të organizuara, së pari të njoftuar si fëmijë shumë të vegjël për një ambient shkollor. Programe të tilla janë në shkolla apo të organizuara nëpër qendra, për fëmijët e moshës së paku 3-vjeçare.

➡ **SNKAE 1: Arsimimi fillor:** Fillimi i studimeve sistematike me të lexuar, shkrim dhe matematika. Programet janë disenjuar në bazë të një njësie për projekt (shpesh me një mësues për shumicën e kohës) më shumë sesa në bazë të lëndës (me mësues të ndryshëm për lëndë të ndryshme). Mosha e hyrjes është prej 5 deri 7 vjeç.

➡ **SNKAE 2: Arsimimi i ulët sekondar:** Fillimi i të mësuarit bazuar në lëndë – për të kompletuar provizionin e arsimit elementar që ka filluar në SNKAE 1 dhe për ta shtrirë themelin për një mësim afatgjatë. Implementimi i plotë i aftësive elementare ngjan në këtë nivel. Kjo fazë është me nënndarje:

- ➡ SNKAE 2A programet janë disenjuar për qasje direkte në SNKAE 3 sipas radhës, e cila do të shpinte tek arsimimi terciar.
- ➡ SNKAE 2B programet janë të disenjuara për qasje direkte në SNKAE 3C.
- ➡ SNKAE 2C programet janë të disenjuara së pari për qasje direkte në tregun e punës. Për të përparuar tek SNKAE 3 kërkohet gjithashtu kompletim i SNKAE 2A apo 2B.

➡ **SNKAE 3: Arsimimi sekondar (më i lartë):** Specializime të mëtutjeshme krahasuar më SNKAE 2. Kjo fazë fillon në fund të shkollimit të detyruar 15 apo 16. përfundimi i suksesshëm i SNKAE 2 është i kërkuar. Kjo fazë vazhdon edhe me nënndarje:

- ➡ SNKAE 3A programet janë disenjuar për qasje direkte tek SNKAE 5A.
- ➡ SNKAE 3B programet janë disenjuar për qasje direkte tek SNKAE 5B.
- ➡ SNKAE 3C programet nuk shpijnë direkt tek arsimimi terciar. Për të përparuar tek SNKAE 5A apo 5B kërkohet gjithashtu përfundimi SNKAE 3A, 3B apo 4A.

- ➡ **SNKAE 4: Arsimimi jo terciar pas shkollës së mesme:** Programe, të cilat kanë larguar kufijtë ndërmjet shkollimit të mesëm të lartë dhe shkollimit pas shkollës së mesme. Përmbajtja nuk është e mjaftueshme që të quhen programe terciare. Të shumtën e herëve jo më të përparuara se SNKAE 3 – që të zgjerojë njohuritë e studentëve të cilët e kanë kryer SNKAE 3. Programe për përgatitje për hyrje në arsimimin terciar.

Kjo fazë është ende me nënndarje:

- ➡ SNKAE 4A programet janë të disenjuara për qasje direkte tek SNKAE 5.
- ➡ SNKAE 4B programet janë të disenjuara së pari për qasje direkte tek tregu i punës dhe nuk i japin qasje SNKAE 5.

- ➡ **SNKAE 5: Faza e parë e arsimimit terciar:** Programet përmbajtja e të cilave është më e avancuar sesa SNKAE 3. Hyrja në këto programe kërkon përfundimin e suksesshëm të programit në SNKAE 3A, 3B apo 4A. Kjo fazë ka edhe nënndarjet:

- ➡ SNKAE 5A kryesisht bazohet në teori, duke tentuar të japë qasje ose tek hulumtimet e programeve të avancuara të SNKAE 6, apo tek profesionet me kërkesa për kualifikim më të lartë (p.sh. mjekët). Mund të jetë e domosdoshme që të kenë më shumë se sa një kualifikim në SNKAE 5A (p.sh. një diplomë fakulteti dhe më vonë magjistrature) para hyrjes në SNKAE 6.
- ➡ SNKAE 5B programet fokusohen në kualifikime specifike profesionale me qasje direkt në tregun e punës. Ato shpesh janë më të shkurtra se programet në SNKAE 5A. Përmbajtja e tyre teorike është zakonisht e pamjaftueshme që të ofrohet qasje e avancuar në programet hulumtuese (para se të kompletohet programi në SNKAE 5A).

- ➡ **SNKAE 6: Faza e dytë e arsimimit terciar:** Programet, të cilat shpijnë në shpërblimin e një kualifikimi të avancuar (zakonisht nivel doktrate apo më tutje). Programet u janë kushtuar studimeve të avancuara dhe hulumtimeve origjinale dhe nuk janë bazuar vetëm në kurse.

Referencat

ILO (1982):	Rezoluta për statistikën e popullatës ekonomike aktive, punësimi, papunësia dhe niveli i ulët i punësimit, Gjenevë
ILO (1998):	Rezoluta për matjen e punësimit dhe situatave joadekuata të punësimit
ILO / MPMS-DPP (2006):	Plani i Veprimit për Punësimin e Rinisë Kosovare
MPMS-DPP (2014c):	Informatat mbi Tregun e Punës në Kosovë (mujor), Prishtinë
ESK (2014):	Analizë e Fuqisë Punëtore (AFP) 2014, Prishtinë

Shumë burime tjera mund të gjinden edhe në:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kosovë www.mpms-ks.org

Qeveria e Kosovës www.rks-gov.net

Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://esk.rks-gov.net/>

Zyra Ndërkombëtare e Punës www.ilo.org

UNDP në Kosovë www.kosovo.undp.org

Botërore në Kosovë www.worldbank.org/kosovo

BE në Kosovë www.euinkosovo.org

OSBE në Kosovë: www.osce.org/kosovo

Ueb faqja për burime të punës: www.lmps.gofor.de